Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik









# BULETINI

## PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK
## LEGJISLATURA E GJASHTË 2017-2021

**Kaçanik**
**Dhjetor 2021**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

Data 03.12.21 Vendi KAÇANIK

| Nj. org. | Numri | Shtojcë |
|---|---|---|
| 01 | 60/01- | 36877-1 |

Zyra e Kryetarit të Komunës
-Sektori i Kuvendit-

# BULETINI

## PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK
## LEGJISLATURA E GJASHTË 2017-2021

Kaçanik
Dhjetor 2021

## HYRJE

Ky Buletin përfshinë aktivitetin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, të legjislaturës së gjashtë, i dalë nga zgjedhjet lokale të Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 22 tetor 2017, respektivisht periudhën nga inaugurimi i Kuvendit të Komunës 20.12.2017 deri më zgjedhjet lokale të datës 17 tetor 2021.

Buletini është përpiluar nga Shërbimi për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës.

Bazë për përpilimin e këtij buletini kanë shërbyer procesverbalet e përpiluara gjatë punës së kuvendit dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm që posedon sektori i kuvendit.
Të dhënat për, rezultatet zgjedhore janë marrë nga Faqja Zyrtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ, të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i këtij Buletini është pasqyrimi i aktivitetit të Kuvendit të Komunës për gjatë kësaj periudhës katërvjeçare, sistemimi i tyre dhe njoftimi i strukturave komunale në drejtim që të jetë sa më transparent aktiviteti i zhvilluar.

Ky material është një bazë e mirë për qytetarët e komunës për me ditur se si ka funksionuar Kuvendi i Komunës për gjatë Legjislaturës së gjashtë, 2017-2021.

## Të përgjithshme

Me 15 qershor 2008 ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës si akti më i lartë juridik i vendit.
Në kapitullin X të Kushtetutës janë përcaktuar, parimet e përgjithshme të vetëqeverisjes lokale, organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale.

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi i Republikës së Kosovës, përveç tjerash ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-040. -Për Vetëqeverisjen Lokale (LVL).

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Organet e Komunës janë :

1. Kuvendi i komunës: dhe
2. Kryetari i komunës.

Kuvendi i komunës është organi më i lartë vendimmarrës në komunë, zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët e komunës.

Kuvendin e komunës e udhëheqë kryesuesi i kuvendit i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve të kuvendit, me shumicë votash, me votim të fshehtë.

Organi më i lartë ekzekutiv i komunës është: Kryetari i Komunës, që zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët e komunës.

Në neni 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, është përcaktuar funksionimi i kuvendit të komunës si vijon: Kuvendi i komunës funksionon në bazë të ligjit për vetëqeverisjen lokale, statutit të komunës dhe akteve tjera nënligjore.

40.1 Kuvendi i komunës funksionon në bazë të këtij ligji, statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

40.2 Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për: a) statutin dhe rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre, b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese; c) miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës; d) planin vjetor të punës dhe raportin vjetor; e) themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij ligji; f) zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komunës; g) niveli i tarifave dhe ngarkesave; h) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi; i) emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike; j) arritjen e marrëveshjeve ndër komunalë dhe brenda komunale; k) marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe l) përgjegjësive të tjera që kërkohen me ligj. 40.3 Për marrjen e vendimeve, kuvendi i komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komitetit të kuvendit të komunës, apo kryetarit të komunës. Kuvendi i komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Në nenin 36 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, është përcaktuar numri dhe zgjedhja e anëtarëve të kuvendit. Sipas pikës 1 (d) e nenit 36, nëse komuna e cila i ka prej 30.001-50.000 qytetarë, kuvendi i komunës përbëhet prej 27 anëtarë. Në këtë rangim hyn komuna e Kaçaniku me numër, 33.409 banorë sipas regjistrimeve të popullsisë së Kosovës të vitit 2011. Sipas nenit 37.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, mandati i anëtarëve të kuvendit të komunës është 4 vite, ndërkaq iu pushon sipas dispozitave të nenit 37.2 të këtij ligji.

Kuvendi i komunës mban së paku 10 mbledhje brenda 1 viti, 5 prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit. Maksimumi i mbledhjeve me pagesë është 12 mbledhje për gjatë një viti.

Takimet e kuvendit të komunës dhe të gjitha komisioneve të tij janë të hapura për publikun.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kuvendi i komunës themelon dy komitete të përhershme:

1. Komitetin për politikë dhe financa dhe
2. Komitetin për komunitete.

Kuvendi i komunës themelon edhe:

- Komitete konsultative; dhe
- Komitete tjera.

## Zgjedhje Lokale 2017

Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës janë mbajtur me datë: 22 tetor 2017
Në këto zgjedhje është votuar për:

1. Kuvendet e komunave; dhe
2. Kryetarë të komunave.

Fushata Zgjedhore ka filluar me 21 Shtator 2017.

**Për Kuvendin e Komunës Kaçanik kanë kandiduar këto subjekte politike:**

1. PDK- Partia Demokratike e Kosovës
2. LDK- Lidhja Demokratike e Kosovës
3. AAK- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
4. LVV- Lëvizja Vetëvendosje
5. NISMA- Nisma për Kosovën
6. Iniciativa Qytetare- Lista për Kaçanikun
7. AKR- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

**Për Kryetar të Komunës së Kaçanikut kanë kandiduar këta kandidatët:**

1. Besim Ilazi - PDK- Partia Demokratike e Kosovës
2. Shkëlqim Jakupi - LDK- Lidhja Demokratike e Kosovës
3. Hajrush Kurtaj - AAK- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
4. Basri Kodra- LVV- Lëvizja Vetëvendosje
5. Agim Çaka – NISMA- Nisma për Kosovën.

Meqenëse në rundi e parë të votimit asnjëri nga 5 kandidatët për kryetar të komunës së Kaçanikut, nuk kanë fituar numrin e mjaftueshëm të votave për t'u zgjedhur kryetar i komunës, atëherë dy kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave, kanë shkuar në; rundin e dytë të votimit- Balotazh.

Rundi i dytë i votimit- Balotazhi, për kryetarë të komunave që nuk kanë fituar në rundin e parë të votimit, është caktuar për datë: 19 Nëntor 2017.

Fushata zgjedhore ka filluar me 13 nëntor 2017.

Komuna e Kaçanikut ka shkuar në Balotazh për kryetar të komunës, me kandidatët:

1. Besim Ilazi nga PDK – Partia Demokratike e Kosovës; dhe
2. Basri Kodra nga LVV- Lëvizja Vetëvendosje.

**Lista e KQZ e Zgjedhjeve të 22 Tetor 2017, rezultatet e votimit sipas subjektet politike garuese, votat e anëtarëve që kanë fituar ulëse në Kuvendit të Komunës Kaçanikut:**

## Kaçanik/Kačanik

| 7 Kaçanik/Kačanik EMRI I PARTISË / NAZIV PARTIJE | VOTAT/ GLASOVA | PËRQINDJA/ PROCENAT | NDARJA E VENDEVE /RASPODELA MESTA |
|---|---|---|---|
| 94 PDK - PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS | 5,995 | 39,49% | 11 |
| 10 LËVIZJA VETËVENDOSJE! | 2,840 | 18,71% | 5 |
| 47 LDK - LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS | 2,307 | 15,20% | 4 |
| 50 AAK - ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS | 2,087 | 13,75% | 4 |
| 31 NISMA - NISMA PËR KOSOVËN | 1,260 | 8,30% | 2 |
| 16 IQ LISTA PËR KAÇANIKUN | 501 | 3,30% | 1 |

### 94 PDK - PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

| # | EMRI/ IME | MBIEMRI/ PREZIME | GJINIA/ ROD | VOTAT/ GLASOVI |
|---|---|---|---|---|
| 1 | BESIM | ILAZI | M | 5,995 |
| 14 | HAMID | GURI | M | 401 |
| 19 | AHMET | LUMA | M | 366 |
| 5 | KEMAL | MËRSELI | M | 334 |
| 8 | KADRI | KRIVENJEVA | M | 306 |
| 4 | BESIM | VISHI | M | 286 |
| 17 | SALI | MALSIU | M | 266 |
| 18 | LIRIJE | SHURDHANI | F | 234 |
| 3 | PRANVERË | LOKU ZHARKU | F | 233 |
| 6 | LIRIJE | LUTA | F | 220 |
| 15 | VLORA | DALLOSHI | F | 201 |

### 10 LËVIZJA VETËVENDOSJE!

| # | EMRI/ IME | MBIEMRI/ PREZIME | GJINIA/ ROD | VOTAT/ GLASOVI |
|---|---|---|---|---|
| 1 | SHPEND | KRUSHA | M | 2,840 |
| 2 | ADNAN | REKA | M | 231 |
| 10 | EKREM | KYÇYKU | M | 231 |
| 9 | FATIJONA | KYÇYKU | F | 117 |
| 18 | KALTRINA | TAFILI | F | 92 |

### 47 LDK - LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

| # | EMRI/ IME | MBIEMRI/ PREZIME | GJINIA/ ROD | VOTAT/ GLASOVI |
|---|---|---|---|---|
| 1 | SELIM | REKA | M | 2,307 |
| 7 | BESNIK | SALIHU | M | 250 |
| 3 | NAZIFE | KRASNIQI | F | 152 |
| 13 | ARLINDA | RAKOCI RAKA | F | 128 |

### 50 AAK - ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS

| # | EMRI/ IME | MBIEMRI/ PREZIME | GJINIA/ ROD | VOTAT/ GLASOVI |
|---|---|---|---|---|
| 1 | YLBER | BAJRA | M | 2,087 |
| 23 | SHEMSEDIN | LUZHA | M | 177 |
| 6 | ALBANA | TRONI | F | 107 |
| 3 | AFËRDITA | SHEHI | F | 78 |

### 31 NISMA - NISMA PËR KOSOVËN

| # | EMRI/ IME | MBIEMRI/ PREZIME | GJINIA/ ROD | VOTAT/ GLASOVI |
|---|---|---|---|---|
| 1 | AGIM | ÇAKA | M | 1,260 |
| 15 | HAFIZE | SALLAHI | F | 176 |

### 16 IQ LISTA PËR KAÇANIKUN

| # | EMRI/ IME | MBIEMRI/ PREZIME | GJINIA/ ROD | VOTAT/ GLASOVI |
|---|---|---|---|---|
| 1 | EKREM | RAKA | M | 501 |

**Rezultatet e zgjedhjeve të datës 22 tetor 2017 në rundin e parë (1) i votimit për Kryetar të Kaçanikut, sipas raportit të KQZ**

Kaçanik/Kačanik




| Kaçanik/Kačanik | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Emri/ Ime | Mbiemri/ Prezime | Emri i Partsë / Naziv Partje | Votave/Glasova | Përqindja/ Procenat |
| BESIM | ILAZI | 94 PDK - PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS | 6,582 | 40,37% |
| BASRI | KODRA | 10 LËVIZJA VETËVENDOSJE! | 3,439 | 21,09% |
| SHKELQIM | JAKUPI | 47 LDK - LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS | 2,985 | 18,31% |
| HAJRUSH | KURTAJ | 50 AAK - ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS | 2,518 | 15,44% |
| AGIM | ÇAKA | 31 NISMA - NISMA PËR KOSOVËN | 781 | 4,79% |

ZGJEDHJET / IZBORI 2017 Page 8 of 39

Në rundi e parë të votimit asnjëri nga 5 kandidatët nuk kanë fituar numrin e mjaftueshëm të votave apo mbi 50% për t'u zgjedhur kryetar i komunës së Kaçanikut, atëherë dy kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave, shkojnë në rundin e dytë të votimit- Balotazh.
Rundi i dytë i votimit- Balotazhi, për kryetarë të komunave që nuk kanë fituar në rundin e parë të votimit, është caktuar për datë: 19 nëntor 2017. Fushata zgjedhore ka filluar me 13 nëntor 2017.

**Rundi i Dytë i votimit, 19 nëntor 2017 për Kryetar të Kaçanikut**

Në rundin e dytë të votimit shkojnë dy kandidatët të cilët kanë fituar më së shumti vota në rundin e parë:

1. Besim Ilazi;
2. Basri Kodra.

Rezultatet janë si në tabelë të paraqitur nga KQZ

Kaçanik/Kačanik




Kaçanik/Kačanik

| Emri/ Ime | Mbiemri/ Prezime | Emri i Partsë / Naziv Partje | Votave/Glasova | Përqindja/ Procenat |
|---|---|---|---|---|
| BESIM | ILAZI | 94 PDK - PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS | 6,782 | 54,73% |
| BASRI | KODRA | 10 LËVIZJA VETËVENDOSJE! | 5,609 | 45,27% |

ZGJEDHJET / IZBORI 2017 Page 6 of 21

Në bazë të votave të fituara në rundin e dytë të votimit, kandidati, Besim Ilazi, ka marrë 54.7 % të votave, ndërkaq kandidati Basri Kodra 45.3 %. **Në bazë të numrit të votave të fituara, kandidati nga subjekti politik i PDK- Partisë Demokratike të Kosovës, Besim Ilazi ka fituar numrin e mjaftueshëm të votave për t'u zgjedhur kryetar i komunës së Kaçanikut, për mandat 4 vjeçar.**

## PËRBËRJA E KUVENDIT TË KOMUNËS
### ( Legjislatura e VI)

### Viti 2017

**Kuvendi i komunës së Kaçanikut i dalë nga zgjedhjet lokale të datës 22 tetor 2017, numëron gjithsej 27 anëtarë, me këtë përbërje:**

| Nr. rend | Emri dhe Mbiemri | Subjekti politik | Pozita |
|---|---|---|---|
| 1. | Besim Ilazi<br>Nexhat Loku | PDK<br>" | Anëtar/ Dorëhequr<br>Anëtar/ Zëvendësuar |
| 2. | Hamid Guri | PDK | Anëtar |
| 3. | Ahmet Luma | PDK | Anëtar |
| 4. | Kemal Mërseli | PDK | Anëtar |
| 5. | Kadri Krivenjeva | PDK | Anëtar |
| 6. | Besim Vishi | PDK | Anëtar |
| 7. | Sali Malsiu | PDK | Anëtar |
| 8. | Lirije Shurdhani | PDK | Anëtare |
| 9. | Pranverë Loku-Zharku | PDK | Anëtare |
| 10. | Lirije Luta | PDK | Anëtare |
| 11. | Vlora Dalloshi | PDK | Anëtare |
| 12. | Shpend Krusha | LVV | Anëtar |
| 13. | Adnan Reka | LVV | Anëtar |
| 14. | Ekrem Kyçyku | LVV | Anëtar |
| 15. | Fatijona Kyçyku | LVV | Anëtare |
| 16. | Kaltrina Tafili | LVV | Anëtare |
| 17. | Selim Reka | LDK | Anëtar |
| 18. | Besnik Salihu | LDK | Anëtar |
| 19. | Nazife Krasniqi | LDK | Anëtare |
| 20. | Arlinda Rakoci- Raka | LDK | Anëtare |
| 21. | Ylber Bajra<br>Hajredin Luta | AAK<br>" | Anëtar/ Dorëhequr<br>Anëtar/ Zëvendësuar |
| 22. | Shemsedin Luzha | AAK | Anëtar |
| 23. | Albana Troni | AAK | Anëtare |
| 24. | Afërdita Shehi | AAK | Anëtare |
| 25. | Agim Çaka<br>Bekim Koxha | NISMA<br>" | Anëtar/Dorëhequr<br>Anëtar/ Zëvendësuar |
| 26. | Hafize Sallahi | NISMA | Anëtare |
| 27. | Ekrem Raka | IQ-Lista për Kaçanikun | Anëtar |

Përbërja e kuvendit të komunës pasqyron përfshirjen e spektrit politik që kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe kanë fituar numrin e mjaftueshëm të votave. Nga kjo listë, 3 kandidatë kanë ofruar dorëheqje në KQZ, nuk e kanë dhënë betimin, për arsye të poshtëshënuar:

1. Anëtari me nr. 1. Besim Ilazi nga PDK, për shkak të kandidaturës së tij për kryetar komune, ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të kuvendit të komunës dhe i njëjti është zëvendësuar me kandidatin, Nexhat Loku nga PDK.

2. Anëtari me nr. 21. Ylber Bajra nga AAK ka ofruar dorëheqje, për shkak të emërimit të tij nënkryetar komune, ndërkaq është zëvendësuar me kandidatin nga AAK, Hajredin Luta.

3. Anëtari me nr. 25. Agim Çaka nga NISMA ka ofruar dorëheqje dhe i njëjti është zëvendësuar me kandidatin nga NISMA, Bekim Koxha.

Kuvendi i komunës Kaçanik, i legjislaturës së VI, i dalë nga zgjedhjet e datës 22 tetor në përbërje 27 anëtarëve, përfaqësohet nga 5 subjektet politike dhe 1 iniciative qytetare me numër të fituar të mandateve (ulëseve) si vijon:

| | |
|---|---|
| **1.** Partia Demokratike e Kosovës (PDK) | **11 mandate( ulëse)** |
| **2.** Lëvizja Vetëvendosje (LVV) | **5 mandate ( ulëse)** |
| **3.** Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) | **4 mandate (ulëse)** |
| **4.** Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) | **4 mandate (ulëse)** |
| **5.** Nisma e Kosovës –NISMA | **2 mandate (ulëse)** |
| **6.** IQ- Lista për Kaçanikun | **1 mandat ( ulëse).** |

## INAUGURIMI ( KONSTITUIMI) I KUVENDIT TË KOMUNËS
**(Legjislatura e VI)**

**Viti 2017**

Me 20 dhjetor 2017, është mbajtur mbledhja inauguruese (konstituive) e kuvendit të komunës, kryesuar nga anëtari me i vjetër Ekrem Kyçyku, deri me zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit, sipas kësaj agjende:

1. Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të kuvendit të komunës;
2. Fjala mirëseardhëse e kryetarit të komunës (në detyrë);
3. Fjala mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të kuvendit të komunës;
4. Dhënia e betimit solemn e anëtarëve të zgjedhur të kuvendit të komunës;
5. Dhëna e betimit solemn e kryetarit të zgjedhur të komunës, Besim Ilazi;
6. Fjala përshëndetëse e kryetarit të komunës;
7. Zgjedhja e kryesuesit të kuvendit të komunës;
8. Fjala përshëndetëse e kryesuesit të kuvendit të komunës; dhe
9. Mbyllja e mbledhjes.

Mbledhjen inauguruese të kuvendit të komunës e ka thirrur dhe hapur kryetari në detyrë i komunës, Besim Ilazi.

**Inaugurimi( Konstituimi) i Kuvendi i Komunës së Kaçanikut**- Organit më i lartë vendimmarrës i komunës, i dalë nga zgjedhjet lokale të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 22 tetor 2017, është bërë me 20 dhjetor 2017, kryesuar nga anëtari me i vjetër i kuvendit të komunës, Ekrem Kyçyku.
Në këtë mbledhje, të zgjedhurit e kuvendit të komunës së Kaçanikut e dhanë betimit dhe e nënshkruan Deklaratën Solemne me 20 dhjetor 2017, dhe nga kjo datë i marrin zyrtarisht detyrën e anëtarit të kuvendit të komunës, duke u ngarkua me detyra, përgjegjësi dhe të drejta, sipas ligjit Nr. 03/I-040 –Për Vetëqeverisje Lokale dhe akteve tjera nënligjore.
Mandati i anëtarëve të kuvendit të komunës, sipas nenit 37.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale është 4 vjeçar, ndërsa iu pushon sipas nenit 37 .2, a, b, c, d, e dhe f dhe 37.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

**Inaugurimit( Konstituimit) i Kryetarit të Komunës Kaçanik**- z. Besim Ilazi, kandidati i zgjedhur në zgjedhjet e 22 tetorit 2017, respektivisht në rundin e dytë të votimit (Balotazhit) të mbajtur me 19 nëntor 2017 e ka dhenë betimin para kuvendit të komunës, me 20 dhjetor 2017.

Me dhënien e betimit dhe nënshkrimit të deklaratës solemne para kuvendit të komunës, Kryetari i komunës- Besim Ilazi, ngarkohet me detyra dhe përgjegjësi për ta përfaqësuar komunën e Kaçanikut dhe vepruar në emër të saj dhe përgjegjësitë tjera, të përcaktuara si në Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe akteve tjera nënligjore.
Kryetari i zgjedhur i komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, e merr zyrtarisht detyrën për të udhëhequr më komunën e Kaçanikut nga data 20.12.2017 për mandat 4 vjeçar. Mandati i kryetarit të komunës përfundon sipas dispozitave të nenit 56.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

**Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Kaçanik** - Në mbledhjen inauguruese të kuvendit të komunës, të datës 20 dhjetor 2017 u zgjodh me votim të fshehtë me shumicë votash- me 17 votë Për, në rundin e I të votimit, Kemal Mërseli për Kryesues të kuvendit të komunës, nga subjekti politik i PDK- subjekt ky i cili e ka numrin më të madh të uleseve apo 11 sish. Për zbatimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit të komunës Kaçanik, u formua komisioni në përbërje:
1. Hamid Guri nga PDK,
2. Fatijona Kyçyku, nga LVV
3. Arlinda Rakoci-Raka nga LDK.
Nga data 20 dhjetor 2017, Kryesuesi i kuvendit të komunës së Kaçanikut, Kemal Mërseli e merr zyrtarisht detyrën për t'i kryesuar dhe udhëhequr mbledhjet e kuvendit të komunës, sipas detyrës zyrtare i kryeson edhe mbledhjet e komitetit për politikë dhe financa.
Mandati i kryesuesit të kuvendit është i lidhur me mandatin e kuvendit të komunës.

**Lista e Anëtarëve të Kuvendit të Komunës në vitin 2018**

| Nr. rend | Emri dhe Mbiemri | Subjekti politik | Pozita |
|---|---|---|---|
| 1. | Nexhat Loku | PDK | Anëtar |
| 2. | Hamid Guri | PDK | Anëtar |
| 3. | Ahmet Luma | PDK | Anëtar |
| 4. | Kemal Mërseli | PDK | Kryesues i Kuvendit |
| 5. | Kadri Krivenjeva | PDK | Anëtar |
| 6. | Besim Vishi | PDK | Anëtar |
| 7. | Sali Malsiu | PDK | Anëtar |
| 8. | Lirije Shurdhani | PDK | Anëtare |
| 9. | Pranverë Loku-Zharku | PDK | Anëtare |
| 10. | Lirije Luta | PDK | Anëtare |
| 11. | Vlora Dalloshi | PDK | Anëtare |
| 12. | Shpend Krusha | LVV | Anëtar |
| 13. | Adnan Reka | LVV | Anëtar |
| 14. | Ekrem Kyçyku | LVV | Anëtar |
| 15. | Fatijona Kyçyku | LVV | Anëtare |
| 16. | Kaltrina Tafili | LVV | Anëtare |
| 17. | Selim Reka | LDK | Anëtar |
| 18. | Besnik Salihu | LDK | Anëtar |
| 19. | Nazife Krasniqi | LDK | Anëtare |
| 20. | Arlinda Rakoci- Raka | LDK | Anëtare |
| 21. | Hajredin Luta | AAK | Anëtar |
| 22. | Shemsedin Luzha | AAK | Anëtar |
| 23. | Albana Troni | AAK | Anëtare |
| 24. | Afërdita Shehi | AAK | Anëtare |
| 25. | Bekim Koxha | NISMA | Anëtar |
| 26. | Hafize Sallahi | NISMA | Anëtare |
| 27. | Ekrem Raka | IQ-Lista për Kaçanikun | Anëtar |

Lista është në bazë të numrin të votave të fituara për anëtar të KK, përpos anëtarëve me numrat 1, 21 dhe 25 të cilët i zëvendësojnë anëtarët e dorëhequr.

**Shefat e grupeve Parlamentare:**

1. PDK, Nexhat Loku;
2. LVV, Ekrem Kyçyku;
3. LDK, Selim Reka;
4. AAK, Shemsedin Luzha.
   Në emër të NISMA, Bekim Koxha;
   Në emër të IQ –Lista për Kaçanikun, Ekrem Raka.

**Ndryshimet në Kuvendin e Komunës në spektrin politik dhe trupave punuese, për gjatë mandatit 4 vjeçar**

Përbërja e kuvendit të komunës si në listën e lartshënuar në ndërkohë pëson ndryshime me atë që, pas një periudhe kohore anëtari i zgjedhur i kuvendit të komunës nga LVV Shpend Krusha jep dorëheqje dhe i njëjti zëvendësohet me 31.01.2020 me Agim Mani nga LVV.
Gjithashtu edhe anëtarja nga AAK, Afërdita Shehi jep dorëheqje dhe e njëjta zëvendësohet me 08.09.2020 me Rabije Sallahi nga po i njëjti subjekt politik AAK.
Gjatë periudhës raportuese, kuvendi i komunës ka pasur ndryshime edhe në përbërjen e spektrit politik, ashtu që anëtarët nga AAK, Shemsedin Luzha, Albana Troni dhe Hajredin Luta deklarojnë së do të veprojnë në KK si Grup i Pavarur. Në ndërkohë Shemsedin Luzha deklarohet së vepron në KK i Pavarur, pastaj i bashkohet LVV, me vonë rreshtohet në ulëse të PDK, ndërkaq anëtarja Albana Troni i bashkohet LVV.
Ndryshim tjetër në spektrin politik është e anëtarit Besim Vishi nga PDK i cili i bashkohet subjektit politik të LVV, ndërkaq Hafize Sallahi nga subjekti politik NISMA kalon në subjektin politik të AAK.

**Trupat punuese të Kuvendit të Komunës dhe ndryshimet që kanë pësuar për gjatë periudhës 4 vjeçare**

**1. Komitetit për politikë dhe financa (KPF) është formuar me Vendim të KK me 31.01.2018, në përbërje :**

1. Kemal Mërseli — PDK — Kryesues sipas funksionit
2. Nexhat Loku — PDK — anëtar,
3. Pranverë Loku-Zharku — PDK — anëtare,
4. ______________ — LVV — anëtar,
5. ______________ — LDK — anëtar,
6. Hajredin Luta — AAK — anëtar,
7. Hafize Sallahi — NISMA — anëtare.

Në ndërkohë me vendim të kuvendit të komunës plotësohet KPF me 2 anëtarë, ashtu që në KPF emërohen anëtarët: Ekrem Kyçyku nga LVV dhe Selim Reka nga LDK, për shkak së këto dy subjekte politike nuk i kishin dhënë emrat e përfaqësuesve të tyre në këtë komitet. Edhe anëtari Hajredin Luta hiqet nga KPF për t'u zëvendësuar me Albana Troni, për shkak të balancimit gjinor.

**Përbërja e KPF është si në listën e poshtëshënuar:**

| Nr. ren. | Emri dhe Mbiemri | subjekti | pozita |
|---|---|---|---|
| 1. | Kemal Mërseli | PDK | Kryesues sipas funksionit |
| 2. | Nexhat Loku | PDK | Anëtar |
| 3. | Pranvera Loku-Zharku | PDK | Anëtare |
| 4. | Ekrem Kyçyku | LVV | Anëtar |
| 5. | Selim Reka | LDK | Anëtar |
| 6. | Albana Troni | AAK | Anëtare |
| 7. | Hafize Sallahi | NISMA | Anëtare |

Më vonë edhe kjo përbërje kah fundi i vitit 2020 pëson ndryshime, pas kalimit të Albana Troni në subjektin tjetër LVV, me çka nuk mundet të bartë edhe pozitën e anëtares në KPF, dhe në vend të saj emërohet për anëtare në KPF, Rabije Sallahi nga AAK.

**2. Komiteti për Komunitete është formuar me vendim të KK me 31.01.2018, në përbërje, 5 anëtarë si vijon:**

1. Lirije Luta, nga PDK anëtare,
2. Kaltrina Tafili nga LVV anëtare,
3. Nazife Krasniqi nga LDK anëtare,
4. Shemsedin Abazi nga KDMLNJ anëtar,
5. Elmihane Krasniqi-Malsiu nga HANDIKOS anëtare.

Më vonë kjo përbërje pëson ndryshime, pasi shtohet numri i anëtarëve në këtë komitet nga 5 anëtarë në 7 anëtarë. Në këtë komitet emërohen për anëtarë: Hajredin Luta nga AAK, dhe Naim Hysa nga OJQ- Kryqi i Kuq.

**Komiteti për komunitete sipas vendimit të kuvendit të komunës të datës 28.02.2018 ka këtë përbërje:**

| Nr. ren. | Emri dhe Mbiemri | subjekti | pozita |
|---|---|---|---|
| 1. | Lirije Luta | PDK | Kryesuese |
| 2. | Kaltrina Tafili | LVV | Anëtare |
| 3. | Nazife Krasniqi | LDK | Anëtare |
| 4. | Hajredin Luta | AAK | Anëtar |
| 5. | Shemsedin Abazi | Shoqëria Civile KMLDNJ | Anëtar |
| 6. | Elmihane Malsiu | Shoqëria Civile/ HANDIKOS | Anëtare |
| 7. | Naim Hysa | Shoqëria Civile Kryqi i Kuq | Anëtar |

Kryesues i komitetit për komunitete është zgjedhur, Lirije Luta.

**3. Komitetet Tjera: Nga Komitetet tjera është formuar,**
**Komiteti për Shërbime Publike, në përbërje;**

| Nr. rend. | Emri dhe Mbiemri | subjekti | Pozita |
|---|---|---|---|
| 1. | Hamid Guri | PDK | Anëtar |
| 2. | Lirije Shurdhani | PDK | Anëtare |
| 3. | Adnan Reka | LVV | Anëtar |
| 4. | Arlinda Rakoci- Raka | LDK | Anëtare |
| 5. | Afërdita Shehi | AAK | Anëtare |

Kryesues i Komitetit për Shërbime Publike është zgjedhur, Hamid Guri.

Kjo përbërje në fund të vitit 2020 pëson ndryshime me atë Afërdita Shehi për shkak të dorëheqjes se saj nga pozita e anëtarit të KK, i pushojnë edhe pozitat tjera që i ushtron dhe ne vend të saj në komitetin për shërbime publike emërohet Kjani Sallahu- nga OJQ/ Shoqëria civile, pasi që sipas UA në këtë komitet duhet të përfshihen edhe anëtarë nga OJQ.

**Përbërja e Ekzekutivit të Komunës Kaçanik në vitin 2018:**

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Pozita |
|---|---|---|
| 1. | Besim Ilazi | Kryetar i Komunës |
| 2. | Ylber Bajra | Nënkryetar i Komunës |
| 3. | Festim Neziraj | Drejtor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme (DAP) |
| 4. | Diana Reka | Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS) |
| 5. | Bahri Selimi | Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim(DEFZH) |
| 6. | Zahir Doda | Drejtor i Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë (DAK) |
| 7. | Ukshin Qallaku | Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUKMM) |
| 8. | Ramadush Osmani | Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë (DSHPE) |
| 9. | Fatmir Loku | Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari (DBZHRP) |

Me Ekzekutivin e komunës udhëheqë, Kryetari i Komunës, Besim Ilazi.

Emërimet për; nënkryetar të komunës dhe për shtatë (7) drejtorë të drejtorive komunale të përcaktuara si me lartë, janë bërë me vendime të kryetarit të komunës.
Ky përfaqësim është bërë në bazë të një marrëveshje politike të cilën e kanë bërë dy subjektet politike në koalicion: PDK-AAK. Në bazë të marrëveshjes së lidhur, subjekti politik i PDK udhëheq me 5 drejtori, ndërsa subjekti politik i AAK, udhëheq me nënkryetarin e komunës, Ylber Bajra dhe Fatmir Loku udhëheqë me Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërkaq drejtori Zahir Doda i cili udhëheqë me Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës, nuk ka deklaruar së është në ndonjë subjekt politik.

## AKTIVITETI I KUVENDIT TË KOMUNËS
## (Legjislatura e VI)

### Viti 2018

### Mbledhja I

Me 24.01.2018, është mbajtur mbledhja e I (parë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli- Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e kuvendit të komunës;
2. Vendimi për formimin e komitetit për politikë dhe financa, në përbërje;
   1. Kemal Mërseli PDK Kryesues sipas funksionit,
   2. Nexhat Loku PDK anëtar,
   3. Pranvera Loku-Zharku PDK anëtare,
   4. ________________ LVV anëtar,
   5. ________________ LDK anëtar,
   6. Hajredin Luta AAK anëtar,
   7. Hafize Sallahu NISMA anëtare.
3. Vendimi për formimin e komitetit për komunitete, në përbërje, 5 anëtarë;
   1. Lirije Luta, nga PDK anëtar,
   2. Kaltrina Tafili nga LVV anëtar,
   3. Nazife Krasniqi nga LDK anëtar,
   4. Shemsedin Abazi nga KDMLNJ anëtar,
   5. Elmihane Krasniqi-Malsiu nga HANDIKOS anëtar.

   Kryesuesi i këtij komiteti zgjidhet nga radhët e anëtarëve.
4. Vendimi për aprovimin e planit të punës së kuvendit të komunës, për vitin 2018;
5. Vendimi për aprovimin e planit të punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2018;
6. Debatohet propozim vendimi për formimin e këshillit komunal për siguri në bashkësi (KKSB), i njëjti shtyhet për mbledhjen vijuese të KK;
7. Vendimi për lejimin e mjeteve financiare, për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës;
8. Vendimi për lejimin e mjeteve financiare, për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
9. Informatë e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor, 2017/2018;
10. Informatë për përformancën e komunës për vitin 2016.

### Mbledhja II

Me 28.02.2018, është mbajtur mbledhja e II (dytë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli- Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e I (Parë) e rregullt e kuvendit të komunës;
2. Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit për formimin e KPF, ashtu që në KPF emërohen anëtarët:

Ekrem Kyçyku nga LVV; Selim Reka nga LDK. Ndërkaq nga KPF hiqet, Hajredin Luta nga AAK për t'u zëvendësuar me Albana Troni nga AAK, për shkak të balancimit gjinor.

Me Vendimin e ndryshuar për formimin e KPF të datës 24 Janar, 2018, KPF ka këtë përbërje:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Kemal Mërseli, | PDK | Kryesues sipas funksionit, |
| 2. Nexhat Loku | PDK | anëtar, |
| 3. Pranverë Loku-Zharku, | PDK | anëtare, |
| 4. Ekrem Kyçyku | LVV | anëtar, |
| 5. Selim Reka | LDK | anëtar, |
| 6. Albana Troni | AAK | anëtare, |
| 7. Hafize Sallahi | NISMA | anëtare. |

3. Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit për formimin e komitetit për komunitete të datës 24 janar 2018, ashtu që me ndryshim plotësimet, komiteti për komunitete ka këtë përbërje 7 anëtarë, me këtë përfaqësim:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Lirije Luta, | nga PDK | anëtare, |
| 2. Kaltrina Tafili | nga LVV | anëtare, |
| 3. Nazife Krasniqi | nga LDK | anëtare, |
| 4. Hajredin Luta | nga AAK | anëtar, |
| 5. Shemsedin Abazi | nga KDMLNJ | anëtar, |
| 6. Elmihane Krasniqi-Malsiu | nga HANDIKOS | anëtare, |
| 7. Naim Hysa | nga Kryqi i Kuq | anëtar. |

Kryesuesi i komitetit zgjidhet nga radhët e anëtarëve. Kryesues i këtij komiteti është zgjedhur Lirije Luta.

4. Vendimi për formimin e këshillit komunal për siguri në bashkësi (KKSB) në përbërje

1. Kryetari i Komunës-Kryesues,
2. Komandanti i Stacionit Policor në Kaçanik,
3. Përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Kaçanik,
4. Përfaqësuesi nga komuniteti etnik pakicë në komunë,
5. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete,
6. Zyrtari për Barazi Gjinore,
7. Drejtori i Drejtorisë për Arsim,
8. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit,
9. Përfaqësuesi i FSK-së,
10. Përfaqësuesi i Këshillit Lokal për Siguri Publike,
11. Kryesuesi i Ekipit Veprues Komunal për Siguri në Bashkësi,
12. Përfaqësuesi nga Sektori i Emergjencave Civil Komunale,
13. Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
14. Përfaqësuesi i OJQ-ve lokale,
15. Përfaqësuesi i mediave lokale,
16. Përfaqësuesi i bizneseve lokale,
17. Përfaqësuesi nga komuniteti lokal i personave me aftësi të kufizuar.

5. Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, për shpenzim me buxhetin e vitit 2018;

6. Vendimi për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve për KRU " Bifurkacioni " – Sh. A. njësia në Kaçanik, në përbërje:

1. Hamid Guri nga PDK,
2. Shpend Krusha nga LVV,
3. Bahri Selimi nga Ekzekutivi i Komunës.

7. Vendimi për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve për KRM " Pastërtia " – Sh. A. Njësia në Kaçanik;

8. Vendimi për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve për NPK "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Kaçanik, në përbërje:

1. Afërdita Horuni nga AAK,
2. Adnan Reka nga LVV,
3. Ukshin Qallaku nga Ekzekutivi i Komunës.

9. Vendimi për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, në përbërje:

1. Sali Malsiu nga PDK,
2. Shpend Krusha nga LVV,
3. Besnik Salihu nga LDK,
4. Festim Neziraj nga Ekzekutivi i Komunës,
5. Menduh Krasniqi nga Ekzekutivi i Komunës.

   Ky komision është kryesuar nga drejtori i Administratës së Përgjithshme, Festim Neziraj.

10 Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pjesës së parcelës kadastrale Nr. 00246-0, Z.K Soponicë, e evidentuar në emër të Esat Xhemal Guri nga f. Nikaj, për zgjerimin e lokacionit të varrezave të dëshmorëve;

11 Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës kadastrale Nr. 01507-0 në vendin, "Guri i Zi" ZK Biçec, PSH, Ekonomia Pyjore në Kaçanik, për ndërtimin e objekteve publike;

12 Vendim paraprak për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, parcela kadastrale Nr. 00565-0, Arë e klasës të 3 (Tretë) ,ZK Bob, në emër të Esat Dema;

13 Vendim paraprak për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, parcela kadastrale Nr. 00203-5, Arë e klasit të 3 (Tretë) ,ZK Bob, në emër të Kemajl Dema;

14 Vendimi për ndërrimin e destinimit të ngastrave kadastrale 183-2; 183-1; 182-0; 180-6; dhe 180-7, në ZK Bob, nga toka bujqësore në tokë ndërtimore- zonë ndërtimi, banim e afarizëm.

**Mbledhje Solemne**

Në shënim të, shpalljes së Pavarësisë së Kosovës është mbajtur një mbledhje solemne me 17 shkurt 2018, kryesuar nga Kemal Mërseli, me këtë agjendë:

1. Fjala përshëndetëse e kryesuesit të kuvendit të komunës;
2. Fjala përshëndetëse e kryetarit të komunës, Besim Ilazi;
3. Fjalë përshëndetëse e përfaqësuesve të subjekteve politike në kuvend;
4. Fjalë përshëndetëse të disa veprimtarëve të çështjes kombëtare ;

5. Ndarja e mirënjohjeve Post Mortum, për:
   - Ish anëtarëve të kuvendit të komunës të legjislaturave; 2000-2017;
   - Ish kryetarëve të shoqatës së veteranëve të luftës së UÇK,;
6. Mbyllja e mbledhjes.

Në këtë mbledhje përpos anëtarëve të kuvendit të komunës, ishin të ftuar të marrin pjesë; personalitete të njohura, familjarë dhe mysafirë të tjerë, përfaqësues të OJQ-ve, dhe qytetarë të tjerë të interesuar.

**Ftesë për mbledhje të Jashtëzakonshme**

Me rastin e 8 marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas, është ftuar një mbledhje e jashtëzakonshme me kërkesën e LVV, me temën: Dhuna në familje në komunën e Kaçanikut. Kjo mbledhje nuk është mbajtur në mungesë të kuorumit.

**Mbledhja III**

Me 30.03.2018 është mbajtur mbledhja e III (tretë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e II (Dytë) e rregullt e kuvendit të komunës;
2. Vendimi për aprovimin e raportit të punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2017;
3. Vendimi për aprovimin e raportit vjetor financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017;
4. Vendimi për inicimin e procedurës dhe formimin e komisionit për ndryshim plotësimin e statutit të komunës së Kaçanikut, në përbërje :
   1. Besim Vishi anëtar i KK nga PDK,
   2. Shpend Krusha anëtar i KK nga LVV,
   3. Arlinda Rakoci-Raka anëtare e KK nga LDK,
   4. Shemsedin Luzha anëtar i KK nga AAK,
   5. Festim Neziraj anëtar, Drejtor i DAP,
   6. Ilir Lumi anëtar, Zyrtar ligjor i Komunës,
   7. Daut Rudi anëtar, Ekspert (avokat) nga OJQ.

   Kryesues i komisionit është zgjedhur Festim Neziraj.
5. Vendimi për inicimin e procedurave për themelimin e Teatrit të Qytetit të Kaçanikut, si institucion me status publik;
6. Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në përbërje:
   1. Kadri Krivenjeva anëtar i KK nga PDK,
   2. Kaltrina Tafili anëtare e KK nga LVV,
   3. Besnik Salihu anëtar i KK nga LDK,
   4. Hidajete Guri anëtare nga Ekzekutivi i Komunës,
   5. Remzi Shabani anëtar nga Ekzekutivi i Komunës,
   6. Zylfi Koxha anëtar nga Ekzekutivi i Komunës,
   7. Zekirja Elezi anëtar nga OJQ/ ekspert i kadastrave.

7. Vendimi për marrjen e vendimit paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrave Nr. 01436-0, Arë e Kasës së 3, në emër të Adem S. Luma;

8. Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrave Nr. 600-2, tokë pyjore- Mal i klasës së 2 (dytë), zona kadastrave Bajnicë, në pronësi të " Green Hill" Sh.P.K;

9. Informatë për dëmet e shkaktuara nga të reshurat e shiut;

10. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi (KKSB) për vitin 2018;

11. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2018.

**Mbledhja IV**

Me 27.04.2018, është mbajtur mbledhja e IV (katërt) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e III (Tretë) e rregullt e kuvendit të komunës;

2. Vendimi për aprovimin e raportit financiar për periudhën, janar-mars 2018;

3. Aprovimi i rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Kaçanikut;

4. Vendimi për dhënien në menaxhim të përkohshëm, Tregun e Gjelbër, Ndërmarrjes Publike " Stacioni i Autobusëve" Sh. A. Kaçanik;

5. Vendimi për formimin e komitetit për shërbime publike, në përbërje:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Hamid Guri, | PDK | anëtar, |
| 2. Lirije Shurdhani, | PDK, | anëtare, |
| 3. Adnan Reka, | LVV | anëtar, |
| 4. Arlinda Rakoci-Raka | LDK | anëtare, |
| 5. Afërdita Shehi, | AAK | anëtare. |

Kryesues i këtij komiteti është zgjedhur, Hamid Guri.

6. Vendimi për dhënien e pëlqimit, organizatorit të Fondacionit" Idriz Seferi" për gdhendjen në shkëmb të figurës – heroit kombëtar, Idriz Seferi të Gryka e Kaçanikut;

7. Vendimi për aprovimin e planit të mbrojtjes nga zjarri për komunën e Kaçanikut.

## Mbledhja e V

Me 30,05.2018, është mbajtur mbledhja e V (pestë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;

2. Vendimi për ndarjen e mjeteve buxhetore sipas programeve dhe kodeve të projekteve kapitale;
3. Vendimi për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale; në përbërje prej 5 anëtarëve, 2 anëtarë nga kuvendi, 2 anëtarë nga ekzekutivi dhe 1 anëtar nga OJQ. Nga kuvendi i komunës, për anëtarët të komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale janë caktuar:
    1. Besim Vishi, nga PDK,

    2. Adnan Reka, nga LVV.

4. Vendim paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 0125 - 0, tokë bujqësore e klasës së 3 në zonën kadastrale në Kovaçec, në pronësi të Abdyl Troni;

5. Vendim paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 0564-0 tokë bujqësore e klasës së 3 në zonën kadastrale në Sllatinë, të pronës së Besim Terziu;

6. Vendimi paraprak për marrjen e vendimit për ndryshimin e destinimit sipas planit rregullativ të zonë së I (Parë) dhe një pjesë të zonës së II (Dytë) në parcelën kadastrale 516 në pronësi të Mevlude Dushkaja;

7. Vendimi për ndryshimin e destinimit sipas planit zhvillimor komunal të parcelës kadastrale Nr. 223-1 në zonën kadastrale në Bob, në pronësi të Fatmir Livoreka;

8. Informatë e MAPL për kualifikimin e komunës së Kaçanikut për përfitimin e Grantit të Përformancës, në bazë të vlerësimit të shërbimeve cilësore me qytetarët e komunës, për vitin 2016.

## Mbledhja e VI

Me 29.06.2018, është mbajtur mbledhja e VI (gjashtë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;

2. Debatohet drafti final për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës, 01Nr. 3588/2008 të datës 25.09.2008 dhe i njëjti vendoset të shtyhet për mbledhjen vijuese të KK;
3. Vendimi për aprovimin e kornizës afatmesme buxhetore e komunës së Kaçanikut, për vitet; 2019-2021 dhe e njëjta lëshohet në procedurë të debatit publik me qytetarë;

4. Vendimi për aprovimin e programi trevjeçarë i banimit të komunës së Kaçanikut, për vitet, 2018-2021;

5. Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik, parcelën kadastrale Nr. 941-18694/18, në emër të, Dijamant (Bajrush) Shehu, për ndërtimin e trotuarit të rrugës" Sali Bajra" dhe hapësirës publike për gjelbërimin pran Gjykatës Themelore-Dega në Kaçanik dhe Qendrës për Punë Sociale;

6. Vendim për ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i komunës së Kaçanikut për shpenzimet e zhvarrimit dhe transferimin e eshtrave të dy ish-luftëtarëve.

**Mbledhja e VII**

Me 17.07.2018, është mbajtur mbledhja e VII (shtatë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;

2. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;

3. Vendimi për aprovimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit për pasqyrat vjetore financiare të komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2017;

4. Aprovimi i rregullores për organizimin e punës në shkolla fillore të mesme të ulëta dhe të mesme te larta;
5. Vendimi për fillimin e procedurave për rishqyrtimin e planit zhvillimor komunal dhe harmonizimin e tij me ligjin e planifikimit hapësinor 04/L-174;

6. Vendimi për shfuqizim e Vendimit të kuvendit të komunës 01.Nr.350/02-15509/18 për ndryshimin e destinimit të parcelës nga" Zonë ndërtimore P+2" në "Zonë ndërtimore P+5" të në parcelën kadastrale Nr. 223-1, zona kadastrale, Bob, në emër të Fatmir Livoreka;
7. Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të kuvendit të komunës 01.Nr.350/02-15507/18-për ndryshimin e destinimit të parcelës Nr. 516-1 zona kadastrale Kaçanik me destinim rekreative sportive, e destinuar në zonë për afarizëm dhe industriale, në pronësi të Mevlude Dushkaja.

**Mbledhja e VIII**

Me 31.07.2018, është mbajtur mbledhja e VIII (tetë) rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;

2. Raporti i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi (KKSB) për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018;

3. Raporti gjashtëmujor financiar për periudhën: janar-qershor 2018;

4. Vendimi për transferimin/ rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit 2018;

5. Vendimi paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr.0968-10, tokë bujqësore e klasës së III-të, në zonën kadastrale Kaçanik i Vjetër në pronësi të Xheladin Krasniqi;

6. Vendimi paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr.0968-9, tokë bujqësore-kullosë e klasës së III-të zona kadastrale Kaçanik i Vjetër në pronësi të Xhevahir Krasniqi;

7. Vendimi paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të parcelës kadastrale nr.0968-7, tokë bujqësore kullosë e klasës së III-të, zona kadastrale Kaçanik i Vjetër në pronësi të Abedin Krasniqi;

8. Raporti i përformancës së komunave për vitin 2017, me theks të veçantë, përformanca e komunës së Kaçanikut;

9. Aprovohet kërkesa e shefit të GP të LVV– Ekrem Kyçyku, për ndërtimin e një, Hyrje-Dalje ( Kyçje – Ç' Kyçje) në Autostradën "Arbër Xhaferi" Segmenti: Kaçanik- Hani i Elezit dhe anasjelltas.

Kërkesa u vendos të hartohet nga përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike dhe e njëjta përmes zyrës së kryetarit të komunës t'iu dërgohet organeve relevante të qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërkaq Lokacioni- vendi i kyçje - ç kyçje në autostradë në afërsi të qytetit të Kaçanikut, mbeti të përcaktohet nga ekspertë të lëmit përkatës.

**Mbledhja e IX**

Me 27.09.2018, është mbajtur mbledhja e IX (nëntë) të rregullt Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli,- Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;

2. Vendimi për buxhetin e komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2019 dhe vlerësimet për vitet, 2020-2021;
3. Vendimi për transferimin/ rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit 2018;

4. Vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, në shfytëzim afatshkurtër;
5. Vendimi për ndryshimin e destinimit sipas PZHK për parcelën kadastrale Nr. 516-1, zona kadastrale, Kaçanik;

6. Vendimi për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës 01Nr. 350/02- 21705/18 – për rishqyrtimin e planit zhvillimor komunal për komunën e Kaçanikut;

7. Informatë e DAK, për fillimin e vitit shkollor 2018/2019.

**Mbledhja e X**

Me 30.10.2018, është mbajtur mbledhja e X (dhjetë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;

2. Aprovohet rregullorja për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre;

3. Vendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore të komunës për vitin 2018;

4. Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, parcelën kadastrale Nr. 00587-2, ZK në Kaçanik, Agjennsionit të punësimit të Republikës së Kosovës;

5. Vendim për formimin e komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara në përbërje 7 anëtarë. Formohet paneli që do të merret me procedurat e zgjedhjes së këtij komiteti, në përbërje prej 5 anëtarëve dhe atë:
   1. Ahmet Luma, nga PDK,
   2. Kaltrina Tafili nga LVV
   3. Arlinda Rakoci-Raka nga LDK.
   4. Një përfaqësues nga ekzekutivi i komunës, caktohet nga kryetari i komunës,
   5. Një përfaqësues nga OJQ-të/ Lënda: 01 Nr. 104/02-34370/18.

6. Informatë për përfundimin e vitit shkollor, 2017/2018;

7. Informatë – Përmbledhja e rezultateve për vitin 2017, për Grantin e performancës-komuna Kaçanik.

**Mbledhja e XI**

Me 29.11.2018 është mbajtur mbledhja e XI (njëmbëdhjetë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;

2. Aprvohet rregullorja për tatimin për pronën e paluajtshme për vitin 2019;

3. Raporti financiar për periudhën: janar- shtator 2018;

4. Vendimi për hartimin e planit zhvillimor komunal;

5. Aprovohet plani lokal i veprimit për persona me aftësi të kufizuara në komunën e Kaçanikut, 2019-2021.

## Mbledhja e XII

Me 27.12.2018 është mbajtur mbledhja e XII (dymbëdhjetë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;
2. Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar, shkollave të komunës;
3. Aproovimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2019;
4. Aprovimi i planit të punës së këshillit komunal të sigurisë në bashkësi (KKSB) për vitin 2019;
5. Aprovimi i planit të punës së komitetit për shërbime publike për vitin 2019;
6. Aprovimi i planit të veprimit për transparencë, për vitin 2019;
7. Aprovimi i planit të integritetit të komunës së Kaçanikut për vitet, 2018-2021;
8. Raport i shoqatës së bjeshkatarëve alpiniste "Kaçaniku 2015" për shpenzimin e mjeteve financiare nga subvencionet;
9. Informatë për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale në komunën e Kaçanikut.

5. Vendimi për ndryshim plotësimin e Vendimit të KK 01Nr. 104/02-12813/2018 të datës 27.04.2018 - për formimin e Komitetit për Shërbime Publike;
6. Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2021;

7. Vendimi për ndryshimin dhe plotësohet vendimi i kuvendit të komunës 01Nr. 60/01-1785/2018 i datës 24.01.2018- përkatësisht Vendimit për ndryshim plotësimin e Vendimit të kuvendit të komunës 01Nr. 60/01-5524/2018- për formimin e komitetit për politikë dh fiinanca i datës 28.02.2018, ashtu që;
   Nga komiteti për politikë dhe financa hiqet anëtarja, Albana Lika (Troni), për shkak të kalimit të saj në subjekt tjetër politik, Lëvizjen Vetëvendosje (LVV).
   Për anëtare të komitetit për politikë dhe financa caktohet, Rabije Sallahi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)/ Lënda 01 Nr.060/01-27538/20. Vendimi për Ndryshim plotësimin e Vendimit 01.Nr.104/01-1879/18 i datës 28.02.2020 për themelimin e këshillit komunal për siguri në bashkësi(KKSB);

8. Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.

**Mbledhja e XI**

Me 24.12.2020, është mbajtur mbledhja e XI (Njëmbëdhjetë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;

2. Rregullorja për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës;

3. Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit të KK 01Nr. 104/02-12813/2018 të datës 27.04.2020 –për formimin e Komitetit për Shërbime Publike; ashtu që ish anëtarja e këtij komisioni, Afërdita Horuni (Shehi), zëvendësohet me Kijani Sallahi nga OJQ/ Shoqëria Civile /Lënda: 01Nr. 104/02-29811/20.

4. Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, parcela kadastrale Nr. 00494-15, arë e klasës së 4, në emër të Amer Shaqir Shurdhani, për zgjerimin dhe ndërtimin e rrugës "Ismail Raka" në Kaçanik;

5. Nuk e merr miratimin, rekomandimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (40 vjet), parcelat kadastrale me numrat: 402-0 dhe 403-0, në ZK Kaçanik i Vjetër, P.SH KK Kaçanik;
6. Aprovohet plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2021;

7. Raporti i punës i Shtabit Komunal për parandalimin e Covid -19;

8. Raport i përmbushjes së planit të integritetit të komunës së Kaçanikut për vitin 2019;

9. Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuara gjatë vitit 2020, shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Kaçanikut.

**MBLEDHJE SOLEMNE**

Komuna e Kaçanikut, gjatë vitit 2020, ka mbajtur 3 mbledhje me karakter solemn, organizuar nga Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, dhe atë; me datë 17.02.2020, një mbledhje Solemne i kushtohet, Ditës së Pavarësisë së Kosovës. Me 11.06.2020 një mbledhje solemne i kushtohet, Ditës së Çlirimit të Komunës dhe më datë 10.08.2020, një mbledhje solemne i kushtohet, Ditës së Dëshmorëve të Komunës.

**DEBATE PUBLIKE**

Komuna e Kaçanikut, gjatë vitit 2020, ka organizuar dhe mbajtur debate publike me qytetarë të komunës për çështje të përgjithshme dhe për çështje të veçanta, si, për; Buxhetin e komunës dhe për çështje tjera më rëndësi për komunën të organizuara nga Kryetari i Komunës, ndërkaq janë organizuar dhe mbajtur nga Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me KPF 2 dëgjime publike për buxhetin e komunës.

**MONITORIMI I MBLEDHJEVE**

Monitorimi i mbledhjeve të rregullta të kuvendit nga strukturat vendore është bërë nga MAPL-a, përmes Tel-Prezencës, nga zyrtari Gëzim Sahiti, ndërsa nga strukturat ndërkombëtare, mbledhjet e rregullta të Kuvendit, janë monitoruar kryesisht nga OSBE-a, ndërkaq nga OJQ janë monitoruar nga KDI, Kjani Sallahu.

## PËRBËRJA E KUVENDIT TË KOMUNËS
## (Legjislatura e VI)

### Viti 2021

Përbërja e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, të Legjislaturës së VI, në vitin 2021 është si vijon:

| Nr. rend | Emri dhe Mbiemri | Subjekti Politik | Pozita |
|---|---|---|---|
| 1. | Nexhat Loku | PDK | Anëtar |
| 2. | Hamid Guri | PDK | Anëtar |
| 3. | Ahmet Luma | PDK | Anëtar |
| 4. | Kemal Mërseli | PDK | Kryesues i KK |
| 5. | Kadri Krivenjeva | PDK | Anëtar |
| 6. | Besim Vishi | PDK/LVV | Anëtar |
| 7. | Sali Malsiu | PDK | Anëtar |
| 8. | Lirije Shurdhani | PDK | Anëtare |
| 9. | Pranverë Loku-Zharku | PDK | Anëtare |
| 10. | Lirije Luta | PDK | Anëtare |
| 11. | Vlora Dalloshi | PDK | Anëtare |
| 12. | Agim Mani | LVV | Anëtar |
| 13. | Adnan Reka | LVV | Anëtar |
| 14. | Ekrem Kyçyku | LVV | Anëtar |
| 15. | Fatijona Kyçyku | LVV | Anëtare |
| 16. | Kaltrina Tafili | LVV | Anëtare |
| 17. | Selim Reka | LDK | Anëtar |
| 18. | Besnik Salihu | LDK | Anëtar |
| 19. | Nazife Krasniqi | LDK | Anëtare |
| 20. | Arlinda Rakoci- Raka | LDK | Anëtare |
| 21. | Hajredin Luta | AAK/GP | Anëtar |
| 22. | Shemsedin Luzha | AAK/GP/Pavarur/ LVV | Anëtar |
| 23. | Albana Troni | AAK/GP/LVV | Anëtare |
| 24. | Rabije Sallahi | AAK | Anëtare |
| 25. | Bekim Koxha | NISMA | Anëtar |
| 26. | Hafize Sallahi | NISMA/ AAK | Anëtare |
| 27. | Ekrem Raka | IQ-Lista për Kaçanikun | Anëtar |

Për gjatë vitit 2021, kjo përbërje pëson ndryshime në spektrin politik, ashtu që 3 anëtarët: Albana Troni, Shemsedin Luzha dhe Besim Vishi deklarojnë së i janë bashkuar subjektit politik të Lëvizjes Vetëvendosje –LVV. Në ndërkohë Shemsedin Luzha rreshtohet kah PDK, ndërkaq anëtarja Hafize Sallahi nga NISMA kalon në subjektin politik të AAK.

**Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa(KPF) në vitin 2021;**

| Nr. ren. | Emri dhe Mbiemri | subjekti | pozita |
|---|---|---|---|
| 1. | Kemal Mërseli | PDK | Kryesues sipas funksionit |
| 2. | Nexhat Loku | PDK | Anëtar |
| 3. | Pranvera Loku-Zharku | PDK | Anëtare |
| 4. | Ekrem Kyçyku | LVV | Anëtar |
| 5. | Selim Reka | LDK | Anëtar |
| 6. | Rabije Sallahi | AAK | Anëtare |
| 7. | Hafize Sallahi | NISMA/ AAK | Anëtare/ Dorëheqje |
| | Bekim Koxha | NISMA | Anëtar/ Zëvendësim |

Pa kalimit të Hafize Sallahu në subjektin politik të AAK, është zëvendësuar në KPF me Bekim Koxha nga NISMA, mirëpo Vendimi i KK është kthyer nga MAPL për shkak së është kërkuar të respektohet Ligji për barazi gjinore, kështu që vendimi i KK është anuluar dhe Hafize Sallahi mbetet anëtare e KPF deri në fund të mandatit të KPF, pasi që në subjektin politik NISMA nuk ka pasur ndonjë femër për me zëvendësuar anëtaren e dorëhequr Hafize Sallahu.

**Komitetit për Komunitete, në vitin 2021 ka funksionuar me këtë përbërje:**

| Nr. ren. | Emri dhe Mbiemri | subjekti | pozita |
|---|---|---|---|
| 1. | Lirije Luta | PDK | Kryesuese |
| 2. | Kaltrina Tafili | LVV | Anëtare |
| 3. | Nazife Krasniqi | LDK | Anëtare |
| 4. | Hajredin Luta | AAK/GP | Anëtar |
| 5. | Shemsedin Abazi | Shoqëria civile KMLDNJ | Anëtar |
| 6. | Elmihane Malsiu | Shoqëria civile/ HANDIKOS | Anëtare |
| 7. | Naim Hysa | Shoqëria civile Kryqi i Kuq | Anëtar |

**Shërbime Publike në vitin ka funksionuar në vitin 2021 me këtë përbërje:**

| Nr. rend. | Emri dhe Mbiemri | subjekti | Pozita |
|---|---|---|---|
| 1. | Hamid Guri | PDK | Kryesues |
| 2. | Lirije Shurdhani | PDK | anëtare |
| 3. | Adnan Reka | LVV | Anëtar |
| 4. | Arlinda Rakoci- Raka | LDK | Anëtare |
| 5. | Kjani Sallahu | OJQ/ Shoqëria Civile | Anëtar |

**Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara në vitin 2021 ka funksionuar me këtë përbërje:**

| Nr. ren. | Emri dhe Mbiemri | Pozita |
|---|---|---|
| 1. | Artan Mezraja | Kryesues |
| 2. | Arxhenta Axhami | Anëtare |
| 3. | Mirlinda Axhami-Hysa | Anëtare |
| 4. | Fiknete Krasniqi | Anëtare |
| 5. | Edita Shehu | Anëtare |
| 6. | Albana Fuga | Anëtare/ Dorëheqje |
| 7. | Antigona Axhami-Bafitjaj | Anëtare |

Anëtarja, Albana Fuga ka ofruar dorëheqje në muajin prill të vitit 2021, ndërkaq nuk është zëvendësuar me ndonjë anëtar tjetër. Mandati i këtij komiteti nuk është i lidhur me mandatin e KK.

**Ekzekutivi i Komunës në vitin 2021, ka punuar me këtë përbërje:**

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Pozita |
|---|---|---|
| 1. | Besim Ilazi | Kryetar i Komunës |
| 2. | Ylber Bajra | Nënkryetar i Komunës |
| 3. | Festim Neziraj | Drejtor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme(DAP) |
| 4. | Diana Reka | Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale(DSHMS) |
| 5. | Bahri Selimi | Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim(DEFZH) |
| 6. | Zahir Doda | Drejtor i Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë(DAK) |
| 7. | Ukshin Qallaku | Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit(DUKMM) |
| 8. | Ramadush Osmani | Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë(DSHPE) |
| 9. | Fatmir Loku | Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari(DBZHRP) |

Gjatë vitit 2021 ka pasur ndryshime në ekzekutivin e komunës, ashtu që Diana Reka ka ofruar dorëheqje nga pozita e drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale(DSHMS), ndërkaq pozitën e drejtorit të DSHMS e ka ushtruar, Nënkryetari i Komunës -Ylber Bajra krahas punëve dhe detyrave të punëve të nënkryetarit. Me ekzekutivin e komunës, udhëheqë Kryetari i Komunës, Besim Ilazi.

## Aktiviteti i Kuvendit të Komunës
### (Legjislatura e VI)

### Viti 2021

### Mbledhja e I

Me 29.01.2021, është mbajtur mbledhja e I (parë) rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 11 e rregullt e kuvendit të komunës i vitit 2020;

1. Rregullorja për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale;
3. Aprovohet Draft Kodi i Etikës për zyrtarët e komunës së Kaçanikut;

4. Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021;

5. Aprovohet plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021;

6. Aprovohet plani i punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2021;

7. Aprovohet plani i punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik, për vitin 2021;

8. Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit të kuvendit të komunës 01Nr. 18863/19 të datës 28.06.2019 për formimin e komisionit të ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ashtu që ish anëtarët e komisionit: Milazim Salijaj dhe Zekeria Koxha, zëvendësohen me Ardiana Tusha nga OJQ dhe Ibush Lika nga Ekzekutivi i Komunës / Lënda: 01Nr. 104/02-1520/21;

9. Nuk e merr miratimin, rekomandimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99) vjet kompanisë "NDRIQIMI GROUP" SH.P.K, pronën komunale me Nr. 143-3, sipërfaqe 1.49.95 ha PSH, ZK Doganaj;

10. Nuk e merr miratimin, rekomandimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99) vjet kompanisë "MECATYP" KS SH.P.K, pronën komunale me Nr. 143-1, sipërfaqja, 0.93.88.5 ha, PSH, ZK Doganaj;

11. Nuk e merr miratimin, rekomandimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99) vjet kompanisë "MURSELI COMPANY" SH.P.K, pronën komunale me Nr. 143-1, sipërfaqja, 0.93.88.5 ha, PSH, ZK Doganaj;

12.Informatë e Kryesuesit të kuvendit, për aktivitetin e kuvendit të komunës për vitin 2020;

13. Informatë e DAK, për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2020-2021;

14. Raport i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2020;

15. Vendimi për aprovimin e rekomandimit të komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (40 vjet), kompanisë "KAÇINKA" L.L.C, pronën komunale me numrat: 402-0 dhe 403-0, sipërfaqe: 0,95.48 ha dhe 0.32.99 ha, në ZK Kaçanik i Vjetër, P.SH KK Kaçanik.

**Mbledhja e II**

Me 26.02.2021 është mbajtur mbledhja e II (dytë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;

2. Raporti i punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2020;

3. Raporti vjetor financiar për periudhën: janar-dhjetor 2020;

4. Aprovimi i raportit të punës së komitetit për politikë dhe financa, për vitin 2020;

5. Vendim për lirim nga qiraja komunale për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2021;

6. Informatë e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën: Janar –Dhjetor 2020.

**Mbledhja e III**

Me 18.03.2021 është mbajtur mbledhja e III (tretë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;

2. Aprovimi i Organogrami i komunës së Kaçanikut;

3. Vendimi për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore;
   1. Hajrush Dullovi, Zyrtar i lartë i arsimit, Kryesues i komisionit;
   2. Florije Zeneli, Drejtoreshë në SHFMU "Idriz Seferi" Bob; Anëtare; dhe
   3. Një(1) përfaqësues i MASH-it, Anëtar (propozohet nga ministria).

4. Vendimi për ndryshim plotësimin e Vendimit të KK 01Nr. 60/01-36810/19 i datës 29.11.2019 dhe Vendimi 01Nr.104/02-3037/20 i datës 28.02.2020 që kanë të bëjnë me formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Nga komisioni vlerësues hiqet me kërkesën e tij, Adnan Reka, ndërkaq në vend të tij nuk është caktuar ndonjë anëtar. Nga Komisioni vlerësues hiqet me kërkesën e tij, anëtari nga ekzekutivi i komunës, Bujar Dullovi, ndërkaq në vend të tij caktohet për anëtar, Skënder Sopa.

**Mbledhja e IV**

Me 29.04.2021 është mbajtur mbledhja e IV (katërt) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;

2. Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës së vitit 2021;

3. Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021;

4. Vendimi për subvencionimin e operatorëve të transportit publik të udhëtarëve të komunës së Kaçanikut dhe NPK "Stacioni i Autobusëve" Kaçanik;

5. Shtyhet për mbledhjen vijuese të KK, Propozim Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë e listuar në 21 parcela kadastrale në sip. 3858m2, në ZK Kaçanik, për projektin: Vazhdimi i rrugës "Ismail Raka" – segmenti nga shtëpia e kulturës "Xheladin Kurtaj" deri të "Xhamia e Dëshmorëve" në Kaçanik;

6. Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për katërdhjetë (40) vite, Parcelën kadastrale Nr. 01580-0 në sipërfaqe 23.379m2 ZK Begracë, P.SH – Kullosë e klasës së 3, personit juridik, JLG Constructions SH.P.K NUI; 811498642 me pronar Agron Zeneli, me procedurë të negocimit të ofertës;

7. Vendimi për ndarjen e parcelës kadastrale Nr. 649-0, ZK Kaçanik, P. SH Shtëpia e Shëndetit, për ndërtimin e Shtëpisë Integruese;

8. Rishqyrtimi i Vendimit të KK 01Nr. 60/01-11084 i datës 18.03.2021 sipas kërkesës së MAPL, për harmonizimin e aktit me legjislacionin në fuqi;
9. Vendimi për pushimin e funksionimit të komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

10. Aprovohet raporti i punës i Komitetit për Komunitete, për vitin 2020;

11. Aprovohet Raporti i punës i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2020;
12. Vendimi për Aprovimin e dorëheqjes së anëtares së Komitetit Konsultativ për Persona ma Aftësi të Kufizuara, Albana Fuga.

**Mbledhja e V**

Me 28.05.2021 është mbajtur mbledhja e V (pestë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së IV-të (Katërt) të rregullt të kuvendit të komunës të datës 29.04.2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-11379/21;

2. Raporti tremujor financiar, për periudhën: janar-mars 2021 / Lënda: 01Nr. 05-400/01-13516/21;

3. Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë e listuar në 21 parcela kadastrale në sip. 3858m2, në ZK Kaçanik, për projektin: Vazhdimi i rrugës "Ismail Raka"-segmenti nga shtëpia e kulturës "Xheladin Kurtaj" deri të "Xhamia e Dëshmorëve" në Kaçanik / Lënda: 01Nr. 06-07-464/01-10656/21;

4. Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë në pjesë të parcelave kadastrale: 457-0; 459-0; 460-0, ZK Ivajë, sip. 419m2, pronë e Mefail Rexha, në këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01065-10, në sip. 418m2, ZK Ivajë, P.SH. Rrugët publike të pa kategorizuara / Lënda: 01Nr. 06-941/01-13462/21;

5. Vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave komunale të planifikuara për dhënien në shfrytëzim në vitin 2021 / Lënda: 01Nr.104/02-13736/21;

6. Vendimi për harmonizim të vendimit të kuvendit të komunës 01Nr. 104/02-11086/21 të datës 29.04.2021 me legjislacionin në fuqi, sipas kërkesës së MAPL -Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, për katër dhjetë (40) vjet, pronën e paluajtshme të komunës, personit juridik: JLG Construction SH.P.K.-Kaçanik, NUI:811498642, me pronar Agron Zeneli-Kaçanik, me procedurë të negocimit të ofertës. me procedure të negocimit të ofertës. / Lënda përmban të njëjtin numër: 01Nr. 104/02-11086/21.

Në këtë mbledhje ishte në rend pune edhe Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e komunës së Kaçanikut. Kjo pikë është shtyrë për shqyrtim për mbledhjen vijuese të KK.

**Mbledhja e VI**

Me 15.06.2021 është mbajtur mbledhja e VI (Gjashtë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së V-të (Pestë) të rregullt të kuvendit të komunës të datës 28/05.2021 / Lënda: 01Nr.60/01-13805/21;

2. Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës kadastrale 01003-0, me kulturë Oborr ZK Kaçanik, në emër të Misim Sopa, për Këmbim me pronën komunale me pjesën e parcelës kadastrale 01030-0, me kulturë P.SH. Rrugët publike dhe të pa kategorizuara, ZK Kaçanik;

3. Vendimi për formimin e komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçanik i Vjetër, në përbërje:
    1. Kadri Krivenjeva, anëtar i KK nga PDK,
    2. Besnik Salihu, anëtar i KK nga LDK,
    3. Hafize Sallahu, anëtare e komisionit nga AAK;
    4. Xhelal Gashi, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës; dhe
    5. Rrustem Dema nga sektori jo qeveritar/ OVL e UÇK.

Lënda: 01Nr. 60/01-15789/21.

4. Vendimi për realizimin e një vizitë zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në Komunën e Strugës me datën 8 dhe 9 Korrik 2021, me ftesën e Komunës së Strugës/ Lënda: 01Nr. 60/01-15767/21.

Në këtë mbledhje anëtarja e KK nga NISMA znj. Hafize Sallahi, e bëri një publik një Njoftim për kalimin e saj nga subjekti politik NISMA në subjektit të AAK, dhe kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit të e zëvendësoj edhe në KPF, meqë ajo ulëse i takon subjektit politik- NISMA.

## Mbledhja e VII

Me 30.06.2021 është mbajtur mbledhja e VII (shtatë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së VI-të (Gjashtë) të rregullt të kuvendit të komunës të datës 15.06.2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-15932/21;

2. Vedndim për aprovimin e kornizës afatmesme buxhetore e komunës (KABK) për vitet 2022-2024 dhe e njëjta lëshohet në procedurën e diskutimit publik me qytetarë të komunës / Lënda: 01Nr. 400/03-17423/21;

3. Aprovimi i rregullores së brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare / Lënda: 01Nr. 02-60/01-16867/21;

4. Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr. 104/02-36179/19 - për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut/ Lënda: 01Nr. 02-060/01-17365/21;

5. Vendimi për zëvendësimi i anëtares së KPF nga NISMA, Hafize Sallahi pas kalimit të saj në subjekt tjetër politik- AAK, me anëtarin nga NISMA, Bekim Koxha/ Lënda: 01Nr. 60/01-18413/21;

6. Vendimi për rialokim të mjeteve, sipas buxhetit të vitit 2021/ Lënda: 01Nr. 400/01-17465/21.

## Mbledhja e VIII

Me 30.07.2021 është mbajtur mbledhja e VIII (tetë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së VII-të (Shtatë) të rregullt të kuvendit të komunës të datës 30.06.2021 / Lënda: 01Nr. 060/01-17392/21;

2. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2020 / Lënda: 01Nr. 470/03-20625/21;

3. Vendimi për aprovimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditorit të Zyrës Kombëtare, për PFV'2020 / Lënda: 01Nr. 470/03-20635/21;
4. Për rialokim të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021 nga kategoria ekonomike - shpenzime kapitale, fondi burimorë 10, Në kuadër të nën-programit buxhetor:, shërbimet e shëndetësisë primare (74700) nga projekti me kod 48554 ''Blerja e veturave për nevoja të QKMF-së'' shuma prej 20,000.00€, rialokohet në projektin me kod 50208 ''Rindërtimi i objektit të QMF-së në fshatin Doganaj'' shuma prej 20,000.00€ / Lënda: 01Nr. 400/03-20752/21;

5. Raporti (Informatë) e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për periudhën: janar-qershor 2021 / Lënda: 01Nr. 104/02-20613/21.

6. Vendim për ANULIMIN e Vendimi 01Nr.60/01-18413/21 i datës 30.06.2021 me të cilin është ndryshuar dhe plotësuar Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 01Nr. 60/01-1785/2018 i datës 24.01.2018, Vendimi 01Nr. 60/01-5524/2018 i datës 28.02.2018 dhe Vendimi 01Nr. 060/01-27538/20 i datës 23.11.2020 / Lënda: 01Nr. 60/01-20332/21;
7. Vendim për ANULIMIN e Vendimit të KK 01Nr.60/01-15789/21 të datës 15.06.2021 -për themelimin e komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçanik i Vjetër/ Lënda: 01Nr. 60/01-21134/21;

8. Vendim për ANULIMIN e Vendimit të KK 01 Nr. 06-350/02-8304/21 të datës 15.06.2021- për Shpallje me interes të përgjithshëm publik , patundshmërinë në pjesën e PK 01003-0 ZK Kaçanik, pronë private në emër të Misim Sopa, për Këmbim me pronën komunale me pjesën e PK 01030-0 ZK Kaçanik / Lënda: 01Nr. 60/01-20334/21;

9. Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit 01 Nr.104/02-36179/19 -për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e komunës së Kaçanikut, sipas Kërkesës së MAPL/ Lënda: 01Nr. 104/02-21139/21. Me marrjen e këtij vendimi, anulohet vendimi i kuvendit të komunës 01Nr. 060/01-17365/21 i datës 30.06.2021.

**Mbledhja e IX**

Me 31.08.2021 është mbajtur mbledhja e IX-të (nëntë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e VIII-të (Tetë) të rregullt të kuvendit të komunës të datës 30.07.2021 / Lënda: 01Nr. 060/01-21074/21;

2. Raporti gjashtëmujor finafnciar për periudhën janar- qershor 2021/ Lënda 01Nr.05-400/01-25331/21;

3. Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021/Lënda 01Nr.400/01-24412/21;
4. Vendim për refuzimin e propozim vendimit për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2022/lënda 01Nr.60/01-25522/21.

## Mbledhja e X

Me 16.09.2021 është mbajtur mbledhja e X-të (Dhjetë) e rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, janë diskutuar çështje dhe janë marrë vendime:

1. Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024 / Lënda: 01Nr. 400/03-26144/21;

2. Vendimi për anulimin e vendimit 01nr.104/02-21139/21 të datës 30.07.2021 -për ndryshim plotësimin e vendimit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçaniku/ Lënda: 01Nr. 104/02-28699/21;

3. Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022/ Lënda: 01Nr. 430/03-27288/21;

4. Vendimi për refuzimin e propozim vendimit 01nr. 104/02-27924/21 i datës 09.09.2021- aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të planifikuara për dhënien në shfrytëzim në vitin 2022/ Lënda: 01Nr. 104/02-27924/21.

Për kontributin e tyre 4 vjeçar, të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës iu ndan mirënjohje nga Kryetari i Komunës.
Çështjet e shqyrtuara nga KK të kësaj legjislature janë kryesisht të propozuara nga Kryetari i komunës dhe drejtoritë komunale.

## MBLEDHJE SOLEMNE

Si çdo vit tjetër, edhe në vitin 2021, Komuna e Kaçanikut – nën organizimin e Kryetarit të Komunës, Besim Ilazi, ka mbajtur 3 mbledhje me karakter solemn dhe atë; me datë 17.02.2021, një mbledhje solemne i kushtohet, Ditës së Pavarësisë së Kosovës. Me 11.06.2021, një mbledhje solemne i kushtohet, Ditës së Çlirimit të Komunës dhe më datë 10.08.2021, një mbledhje solemne i kushtohet, Ditës së Dëshmorëve të Komunës.

## DEBATE PUBLIKE

Komuna e Kaçanikut- Kryetari i Komunës gjatë vitit 2021, ka organizuar dhe mbajtur Debate publike me qytetarë të komunës për çështje të përgjithshme dhe për çështje të veçanta, si, për Buxhetin e komunës dhe për çështje tjera më rëndësi për komunën.

## MONITORIMI I MBLEDHJEVE

Monitorimi i mbledhjeve të rregullta të kuvendit të komunës në vitin 2021 nga strukturat vendore janë bërë nga MAPL-a përmes Tel- Prezencës. nga zyrtarët: Gëzim Sahiti dhe Vjosa Ahmetaj.

**Material i bashkangjitur:** Se si ka funksionuar kuvendi i komunës së Kaçanikut i legjislaturës së gjashtë, 2017-2021, këtij Buletini do t'i bashkëngjiten: Informatat vjetore të aktivitetit të kuvendit të komunës sipas viteve: 2017-2018, 2019, 2020 dhe 2021, si dhe materiale tjera të nevojshme të cilat lidhen me këtë legjislaturë.

## Zgjedhjet Lokale 2021

Zgjedhjet vijuese lokale të Republikës së Kosovës janë mbajtur me datë : 17 tetor 2021.
Në këto zgjedhje është votuar për:

1. Kuvendet komunale; dhe
2. Kryetarë të komunave.

Fushata zgjedhore ka filluar me 16 shtator 2021.

**Nga Komuna e Kaçanikut, për Kuvendin e Komunës kanë kandiduar këto subjekte politike dhe kanë fituar këtë numër të ulëseve:**

1. PDK- Partia Demokratike e Kosovës **(12)**
2. LVV- Lëvizja Vetëvendosje (8)
3. LDK- Lidhja Demokratike e Kosovës (4)
4. AAK- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (2)
5. NISMA- Nisma për Kosovën (1).

**Për Kryetar të Komunës së Kaçanikut kanë kandiduar:**

1. Besim Ilazi - PDK- Partia Demokratike e Kosovës;
2. Jeton Raka- LVV- Lëvizja Vetëvendosje;
3. Shkëlqim Jakupi- LDK- Lidhja Demokratike e Kosovës;
4. Shukri Luta- Kandidat i Pavarur;
5. Kastriot Bushi- Kandidat i Pavarur.

Meqë në rundi e parë të votimit asnjëri nga 5 kandidatët që kanë kandiduar për kryetar të komunës së Kaçanikut, nuk kanë fituar numrin e mjaftueshëm të votave për t'u zgjedhur kryetar i komunës, atëherë dy kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave, shkojnë në; rundin e dytë të votimit- Balotazh.

Rundi i dytë i votimit- Balotazhi, për kryetarë të komunave që nuk kanë fituar në rundin e parë të votimit, është caktuar për datë 14 nëntor 2021.

Fushata zgjedhore ka filluar me 08 nëntor 2021.

Komuna e Kaçanikut ka shkuar në Balotazh për kryetar të komunës, me kandidatët.

1. Besim Ilazi nga PDK – Partia Demokratike e Kosovës; dhe
2. Jeton Raka nga LVV- Lëvizja Vetëvendosje.

Në rundin e dytë të votimit, mandatin për kryetar i komunës së Kaçanikut e ka fituar, Besim Ilazi nga PDK. – Partia Demokratike e Kosovës

Të dhënat për legjislaturën vijuese të kuvendit të komunës dhe për kryetarin e komunës, të cilat dalin nga zgjedhjet lokale 2021, i paraqesim në Buletinin vijues për A\aktivitetin e kuvendit të komunës të legjislaturës së shtatë (7) të KK.

**Makfire Malsiu**
**Zyrtare për Punë të KK**
MMalsiu

KAÇANIKU

Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut

Opština Kacanik

Municipal Kacanik

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KACANIK

Data 31-12-18 Vendi KAÇANIK

| Nj. org. | Numri | Shtojce |
|---|---|---|
| 01 | 60/01-4110/18 | |

# INFORMATË

## PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS, NGA KONSTITUIMI I KUVENDIT TË KOMUNËS, 20 DHJETOR 2017 DERI MË 31 DHJETOR 2018

Kaçanik, Dhjetor 2018

# PËRMBAJTJA

HYRJE

QËLLIMI

PËRBËRJA E KUVENDIT

MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS

KOMITETET E KUVENDIT

NJOFTIMET PËR MBLEDHJE

AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS

RAPORTIMI I KRYETARIT NË KUVENDIN E KOMUNËS

MONITORIMI I MBLEDHJEVE

PUBLIKIMI I AKTEVE NË WEB FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS

SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE

SHKELJET LIGJORE TË EVIDENTUARA

AKTIVITETE TË TJERA

PËRFUNDIM

## Hyrje

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Komuna përmes organeve të saj është e obliguar të ushtroj kompetencat në mënyrë ligjore dhe transparente, duke siguruar edhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

Organet e Komunës janë të obliguara që ushtrimin e veprimtarisë së tyre të zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore të organeve qendrore dhe akteve të cilat i nxjerrin vet. Në kuadër të organeve të komunës , Kuvendi është organi më i lart legjislativ, i cili ushtron funksionin e tij në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Kuvendi mban mbledhjet e rregullta në mënyrë që të kryej funksionet në kuadër të fushë veprimtarisë së tij, të cilat kërkohen me legjislacionin në fuqi.

## Qëllimi

Kjo informatë ka për qëllim informimin e qytetarëve, Organizatave Joqeveritare dhe çdo grupi tjetër të interesit rreth funksionimit të Kuvendit, nga konstituimi i Kuvendit të legjislaturës 6, më datën 20 dhjetor 2017, deri më 31 dhjetor 2018. Informata shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e Kuvendit të Komunës.

## Përbërja e Kuvendit

Përbërja e Kuvendit të Komunës ,dalë nga zgjedhjet e lokale të Republikës së Kosovës të mbajtura më 22 tetor 2017,është 27 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 6 subjekte politike me numër të mandateve : Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 11 mandate, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me 5 mandate, Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK) me 4 mandate, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK) me 4 mandate, Nisma për Kosovën(NISMA) me 2 mandate dhe IQ Lista për Kaçanikun me 1 mandat.

Konstituimi i Organeve të Komunës (Kuvendit dhe Kryetarit të Komunës) së Kaçanikut është bërë me 20 dhjetor 2017.Po në këtë mbledhje me votim të fshehtë është zgjedhur edhe Kryesues i Kuvendit ,i cili kryeson Kuvendin e Komunës, Kemal Mërseli nga PDK. Me Kuvendin e Komunës udhëheq PDK, si partia fituese e zgjedhjeve në koalicion me AAK, deri në mbledhjen e fundit të këtij vitit të datës, 27 Dhjetor 2018, në të cilën tre anëtarë të AAK: Shemsedin Luzha, Albana Troni- Lika dhe Hajredin Luta deklarohen me shkrim së kalojnë si të Pavarur të Kuvendit të Komunës dhe vazhdojnë koalicionin me PDK, ndërkaq anëtarja e AAK, Afërdita Shehi, si anëtare e vetme e subjektit politik të AAK, deklarohet së në Kuvendin e Komunës, hiqet nga koalicioni me PDK për të vepruar në opozitë.

## Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

Ligji për Vetëqeverisje Lokale përcakton rregullat e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të siguroj njëtrajtshmëri të punës së këtij organi. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit.

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut bazuar në nenin 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për gjatë vitit 2018, ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta, ndërkaq ka ftuar edhe një mbledhje të jashtëzakonshme ,e cila nuk është mbajtur për shkak të mungesës së kuorumit. Kuvendi i Komunës ka mbajtur 2 mbledhje solemne, njëra me rastin e 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës dhe tjetra në 20 vjetorin e rënies së komandantit legjendar, Adem Jasharit. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit kanë qenë të hapura për publikun.

## Komitetet e Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka formuar dy Komitete të përhershme;

1. Komiteti për Politikë dhe Financa dhe
2. Komiteti për Komunitete.

Kuvendi ka formuar edhe një Komitet tjetër, që është Komiteti për Shërbime Publike, gjithashtu ka formuar edhe Komitetin Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka pasur rol të veçantë në trajtimin dhe adresimin e çështjeve të cilat kanë qenë në interesim të përgjithshëm qytetarëve të komunës. Komiteti për Politikë dhe Financa i ka shqyrtuar të gjitha pikat që i ka pasur në rend dite dhe i ka përcjell për diskutim dhe miratim në Kuvendin e Komunës. Trajtim të veçantë KPF-ja i ka kushtuar çështjeve financiare siç janë : shqyrtimit të buxhetit, kornizës afatmesme buxhetore të komunës si dhe çështje të tjera siç janë; rregulloret komunale, raporteve financiare, ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të PK të klasës së 5 dhe 6 në bazë të kompetencës së bartura nga KK, për të cilat ka marrë vendime adekuate.

Komiteti për Komunitete ka mbajtur 4 mbledhje që kanë qenë të parapara të mbahen në këtë vit. Në mbledhjet e Komitetit për Komunitete janë shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me problemet e qytetarëve.

Komiteti për Shërbime Publike ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje, në të cilat janë shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë kryesisht me shërbimet publike në Komunën e Kaçanikut.

Sa i përket Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të kufizuara, ky Komitet është në formim e sipër.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, pos tjerash ka formuar edhe Komisione siç janë : Komisioni për emërimin, riemërimin dhe rishqyrtimin e ankesave të rrugëve lokale, Komisioni për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës, Komisioni për formimin e këshillave të fshatrave dhe Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës. Gjithashtu Kuvendi i Komunës ka formuar edhe Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.

## Njoftimet për mbledhje

Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës janë njoftuar paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, 7 (shtatë) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftim është shënuar: data e mbajtjes së mbledhjes, koha e mbajtjes së mbledhjes, vendi i mbajtjes së mbledhjes, rendi i ditës për mbledhje edhe materialet e mbledhjes. Materiali i mbledhjes është dërguar në kopje fizike deri me mbledhjen e 6, ndërkaq pas kësaj mbledhje, është dërguar në formë elektronike, pasi anëtarët e KK janë pajisur me Laptop.
Gjatë njoftimit dhe ndarjes së materialeve të mbledhjes, i njëjti njoftim është publikuar në ueb faqen e Komunës .
Njoftimi dhe materialet gjithashtu i janë dërguar edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Materiali i mbledhjes i është dërguar edhe ekzekutivit të komunës, Zyra e Informimit dhe OJQ.

## Aktet e Kuvendit të Komunës

Në periudhën janar – dhjetor 2018, Kuvendi ka shqyrtuar 100 pika të rendit të ditës. Në Kuvendin e Komunës janë miratuar 4 Rregullore komunale, Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe Vendimin për miratimin e Buxhetit për vitin 2019 dhe vlerësimet për vitet 2020-2021,4 Raporte periodike buxhetore ,Raportin dhe Plani vjetor I Kuvendit ,Raporti i Kryetarit për aktivitetin e përgjithshëm të Komunës, Raportet dhe Planet e Komiteteve të Kuvendit dhe Raporti dhe Plani I Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Gjatë kësaj periudhe Kuvendi miratoi 69 Vendime.

Aktet e miratuara rregullojnë fushat e ndryshme të qeverisjes në nivel lokal, si në arsim dhe kulturë. shëndetësi dhe mirëqenie sociale, shërbime publike dhe mbrojtje të ambientit, siguri , bujqësi , urbanizëm etj.

## Raportimi i Kryetarit në Kuvendin e Komunës

Në mesin e përgjegjësive të Kryetarit të Komunës është edhe raporti i Kryetari para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare, si administrues i financave të komunës lidhur me shpenzimet komunale, investimet kapitale dhe shfrytëzimin e parasë publike. Kryetari i Komunës e ka përmbushur obligimin për raportim në Kuvendin e Komunës brenda këtij viti, ku forma e raportimit ka qenë me shkrim dhe atë katër herë për gjatë vitit dhe në formë verbale çdo herë kur

është kërkuar. Gjithashtu ekzekutivi i komunës i është përgjigjur Kërkesave të anëtarëve të KK aty për aty apo në formë të shkruar. Kjo është një formë më e mirë e bashkëpunimit dhe llogaridhënies së ekzekutivit ndaj Kuvendit të Komunës.

### Monitorimi i mbledhjeve

Monitorimi i mbledhjeve të Kuvendit edhe gjatë këtij viti ka qenë i vazhdueshëm. Aktiviteti i Kuvendit është monitoruar nga strukturat ndërkombëtare, siç është OSBE-ja e cila kryesisht i ka përcjellë mbledhjet e KK . Ndërkaq nga strukturat vendore, monitorimi është bërë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e cila vazhdimisht përcjell punën dhe aktivitetin e Kuvendit nga distanca përmes teleprezencës. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit janë mbajtur me dyer të hapura, mirëpo interesimi i OJQ-ve dhe grupeve tjera të interesit ka qenë minimal.

### Publikimi i akteve në ueb faqen zyrtare të Komunës

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2018, të gjitha aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës janë publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit. Kjo mënyrë e publikimit mundëson qasjen e qytetarëve në të gjitha aktet e Kuvendit të Komunës dhe qasje më të lehtë në dokumente zyrtare.

### Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është autoritet mbikëqyrës i komunave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të miratuara në Kuvend. Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2018, të gjitha aktet e miratuara në Kuvend janë dërguar për shqyrtimin e ligjshmërisë në MAPL. Nga të gjitha aktet e dërguara në MAPL, një vendim është kthyer për rishqyrtim për shkak të balancimit gjinor në përbërjen e Komitetit për Komunitete , dy vendime janë kthyer për rishqyrtim për ndërrim destinimin e tokës bujqësore dhe një Vendim për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal. Ndërsa një Vendim tjetër për ndërrim destinim të tokës bujqësore nuk është rishqyrtuar për shkak se MAPL e ka kthyer pas afatit ligjor.

### Aktivitete tjera

Krahas punës në Kuvendit, ka pasur edhe aktivitete të tjera edhe jashtë Kuvendit. Kryesuesi ka prezantuara në të gjitha takimet e organizuara nga MAPL, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendit dhe takime tjera me qëllim të shqyrtimit të problematikave ,evidentimin e pengesave që hasen gjatë punës së Kuvendit dhe gjetjen e formave për tejkalimin dhe lehtësimin punës së Kuvendit në zhvillimin e politikave lokale. Krahas angazhimit të kryesuesit edhe anëtarët tjerë të Kuvendit kanë dhënë kontributin e tyre në takimet e ndryshme, trajnime dhe seminare të organizuara nga Ministritë, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Organizatat siç janë OSBE-ja , DEMOS-I, UNDP-ja ,SPRC-ja dhe USAID.

Përfundime :

-Ftesa për mbledhjet e Kuvendit dhe materialet e mbledhjes janë dërguar, duke respektuar afatet që janë përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale;

- Kuvendi i Komunës, gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje të rregullta, apo maksimumi I mbledhjeve që janë të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale;

- Të gjitha mbledhjet e Kuvendit kanë qenë të hapura për qytetarët, OJQ-t dhe grupet tjera të interesit;

- Monitorimi i mbledhjeve, nga strukturat ndërkombëtare është bërë nga OSBE-ja me praninë e tyre fizike , ndërsa nga niveli qendror ,nga MAPL-ja përmes teleprezencës;

- Kuvendi i Komunës ka mbajtur takime publike me qytetarët për buxhetin e komunës;

-Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës është mbajtur procesverbal dhe i njëjti është publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës;

-Kryetari i Komunës ka raportuar 4 herë me raport të shkruar financiar, para Kuvendit të Komunës;

-Aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

-Të gjitha aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës janë dërguar në MAPL për shqyrtimin e ligjshmërisë, në afatin e përcaktuar ligjor dhe I përkthyer në dy gjuhë;

-Pjesëmarrja e Kryetarit dhe ekzekutivit në mbledhjet e Kuvendit ka qenë pothuajse i përhershëm;

- Incizimi I mbledhjeve është bërë përmes teleprezencës dhe i njëjti është publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Mërseli

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPSTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVO

## Lista e Akteve të aprovua në Legjislaturës së gjashtë (6) të Kuvendit të Komunës 2017-2021

### Viti 2017

**Lista e Akteve të Aprovuara nga KK në vitin 2017**

**Vendime**

1. Vendimi për Inaugurimin e Kuvendit të Komunës të Legjislaturës së 6, të dalë nga zgjedhjet e komunale të 22 Tetorit 2017 / Lënda: 01Nr. 060/01-41541/21;
2. Vendimi për Inaugurimin e Kryetarit të Komunës/ Lënda: 01Nr. 060/01-41545/17;
3. Vendimi për formimin e komisionit për zhvillimin e procedurës për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit/ Lënda: 01Nr. 060/01-41548/17;
4. Vendimi për Zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit/ Lënda: 01Nr. 060/01-41549/17.

---

**Gjithsej 4**

### Viti 2018

**Lista e Akteve të Aprovuara nga KK në vitin 2018**

**Rregullore**

1. Rregullorja Nr. 01.2018 për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 02-104-11899/18;
2. Rregullorja Nr. 02/2018 - Për organizimin e punës në shkolla fillore të ulëta dhe të mesme të larta / Lënda: 01Nr. 60/01-21292/18;
3. Rregulloren Nr. 03/2018- Për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre/ Lënda: 01Nr. 07-104/01-34317/18;
4. Rregullorja Nr. 04/2018- Për tatimit për pronën e paluajtshme për vitin 2019/ Lënda: 01Nr. 05-430/03-36591/18.

---

**Gjithsej 4**

**Vendime**

1. Vendimi për aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2018 / Lënda: 01Nr. 104/02-1881/2018;
2. Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa/ Lënda; 01 Nr. 60/01-1785/2018;
3. Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete / Lënda: 01Nr. 60/01-1787/2018;
4. Vendimi për aprovimin e Planit të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2018 / Lënda: 01Nr. 60/01-1839/2018;
5. Vendimi për lejimin e mjeteve financiare, për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës / Lënda: 01Nr. Nr.400/01-1823/18;
6. Vendimi për lejimin e mjeteve financiare, për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural / Lënda: 01Nr. 08-400/01-1466/18;
7. Vendimi për Plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa/ Lënda: 01Nr. 60/01-5524/2018;
8. Vendimi të KK për formimin e Komitetit të Komuniteteve/ Lënda: 01Nr. 60/01-6406/2018;
9. Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) / Lënda: 01Nr. 104/01-1879/2018;
10. Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, për shpenzim me buxhetin e vitit 2018/ Lënda: 01Nr. 400/01-5151/18;
11. Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRU " Bifurkacioni " – Sh.A. Njësia në Kaçanik/ Lënda: 01Nr. 60/01-5065/18;
12. Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM " Pastërtia " – Sh.A. Njësia në Kaçanik/ Lënda: 01Nr.60/01-5064/18;
13. Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPK "Stacioni i Autobusave" SH.A. Kaçanik/ Lënda: 01Nr. 60/01-5056/18;
14. Vendimi për formimin e Komisionit për emërimin dhe riemërimin dhe shqyrtimin e ankesave të rrugëve lokale/ Lënda: 01Nr. 104/02-5069/18;
15. Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pjesës së parcelës kadastrale Nr. 00246-0, Z.K Soponicë, e evidentuar në emër të Esat Xhemal Guri nga f. Nikaj, për zgjerimin e lokacionit të varrezave të dëshmorëve/ Lënda: 01Nr. 464/01-4965/2018;
16. Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës kadastrale Nr. 01507-0 në vendin, "Guri i Zi" Z.K Biçec, PSH, Ekonomia Pyjore në Kaçanik, për ndërtimin e objekteve publike/ Lënda: 01Nr. 464/01-4962/18;
17. Vendim paraprak për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, parcela kadastrale Nr. 00565-0, Arë e klasës të 3 (Tretë) ,ZK Bob, në emër të Esat Dema/ Lënda: 01Nr. 06-350/01-3505/17;
18. Vendim paraprak për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, parcela kadastrale Nr. 00203-5, Arë e klasës të 3 (Tretë) ,ZK Bob, në emër të Kemajl Dema; dhe
19. Vendimi për ndërrimin e destinimit të ngastrave kadastrale 183-2; 183-1; 182-0; 180-6; dhe 180-7, në ZK Bob, nga toka bujqësore në tokë ndërtimore- zonë ndërtimi, banim e afarizëm/ Lënda: 01Nr. 06-350/01-5092/18;
20. Vendimi për aprovimin e Raportit të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2017/ Lënda: 01Nr. 104/02-8895/18;
21. Vendimi për aprovimin e Raportit Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2017 Lënda: 01Nr. 400/01-8790/18;
22. Vendimi për inicimin e procedurës për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës/ Lënda: 01Nr. 60/01-10643/18;

23. Vendimi për formimin e Komisionit për Ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës/ Lënda: 01Nr. 104/02-9212/18;
24. Vendimi për inicimin e procedurave për themelimin e Teatrit të Qytetit të Kaçanikut, si institucion me status publik/ Lënda: 01Nr. 104/02-8294/18;
25. Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës/ 01Nr. 104/02-8499/18;
26. Vendimi për marrjen e Vendimit Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 01436-0, Arë e Kasës së 3, në emër të Adem S. Luma/ Lënda: 01Nr. 06-350/01-3378/18;
27. Vendimi për marrjen e Vendimit paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 600-2, tokë pyjore- Mal i klasës së 2 (Dytë), Zona Kadastrale Bajnicë, në pronësi të " Green Hill" Sh.P.K/ 01Nr. 06-350/01-39079/18;
28. Vendimi për aprovimin e Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2018/ Lënda: 01Nr. 104/02-9369/18;
29. Vendimi për aprovimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018/ Lënda: 01Nr. 104/02-9727/18;
30. Vendimi për aprovimin e Raportit Financiar për periudhën, Janar-Mars 2018/ Lënda: 01Nr. 05-400/01-12378/18;
31. Vendimi për dhënien në menaxhim të përkohshëm të Tregut të Gjelbër Ndërmarrjes Publike " Stacioni i Autobusëve" Sh. A. Kaçanik/ Lënda: 01Nr. 06-350/02-12655/18;
32. Vendimi për formimin e Komitetit për Shërbime Publike/ Lënda: 01Nr. 104/02-12813/18;
33. Vendimi për dhënien e Pëlqimit, Organizatorit të Fondacionit" Idriz Seferi" për gdhendjen në shkëmb të figurës – heroit kombëtar, Idriz Seferi të Gryka e Kaçanikut/ Lënda: 01Nr. 06-104-12769/18;
34. Vendimi për Aprovimin e Plani i mbrojtjes nga zjarri për Komunën e Kaçanikut/ Lënda: 01Nr. 07-104/01-11876/18;
35. Vendimi për ndarjen e mjeteve buxhetore sipas programeve dhe kodeve të projekteve kapitale/ Lënda: 01Nr. 400/01-15696/18;
36. Vendimi për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale/ 01Nr. 104/02-13397/18;
37. Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 0125- 0, tokë bujqësore e klasës së 3 në Zonën Kadastrale në Kovaçec , në pronësi të Abdyl Troni/ Lënda: 01Nr. 06-350/02-15173/18;
38. Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 0564-0 tokë bujqësore e klasës së 3 në Zonën Kadastrale në Sllatinë , të pronës së Besim Terziu/ Lënda: 01Nr. 06-350/02-15522/18;
39. Vendimi për ndryshimin e destinimit sipas Planit rregullativ të Zonë së I (Parë) dhe një pjesë të Zonës së II (Dytë) në parcelën kadastrale 516 në pronësi të Mevlude Dushkaja/ Lënda: 01Nr. 350/02-15507/18;
40. Vendimi për ndryshimin e destinimit sipas Planit zhvillimor komunal të parcelës kadastrale Nr. 223-1 në Zonën Kadastrale në Bob, në pronësi të Fatmir Livoreka/ Lënda: 01Nr. 350/02-15507/18;
41. Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale NR. 00648-0 në ZK në Kaçanik, për Ndërtimin e trotuarit të rrugës "Sali Bajra" dhe Hapësirës publike për gjelbërimin, pran Gjykatës Komunale dhe QPS në Kaçanik/ Lënda: 01Nr.464/01-18714/18;
42. Vendimi për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut për vitet, 2019 – 2021/ Lënda: 01Nr. 400-1933/18;

43. Vendimi për Aprovimin e Programi Trevjeçarë i Banimit i Komunës së Kaçanikut për vitet; 2018-2021/ Lënda: 01Nr. 03-500/01-18704/18;
44. Vendimi për ndarjen e mjeteve buxhetore për shpenzimet e zhvarrimit dhe transferimin e eshtrave të luftëtarëve, Avdyl Dura dhe Ramë Beka/ 01Nr. 104/01-19943/18;
45. Vendimi për shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 350/02-15509/18 30 Maj 2015 për ndryshimin e destinimit sipas Planit Zhvillimor Komunal të parcelës me Nr. 223-1 nga Zonë ndërtimore P+2 në zonë ndërtimore P+5, ZK Bob/ 01Nr. 350/02-21670/18;
46. Vendimi për shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 350/02-15507/18 i datës 30 Maj 2018 për ndryshimin e destinimit sipas Planit rregullativ të Zonës së parë dhe një pjese të Zonës së dytë të Parcelës Kadastrale Nr. 5161-1, ZK Kaçanik;
47. Vendimi për rishqyrtimin e Planit zhvillimor të Komunës Nr. 06-9849/2010 të datës 28.12.2010 dhe harmonizimin e tij me ligjin e Ligjit për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174;
48. Vendimi për Aprovimin e Planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve nga të gjeturat e Auditorit për pvf 2017/ Lënda; 01Nr. 470/04-21452/18;
49. Vendimi për aprovimin Raportit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi(KKSB) për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018/ Lënda: 01Nr. 60/01-23637/18;
50. Vendimi për transferimin/ rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit 2018/ Lënda: 01Nr. 60/01-24351/18;
51. Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr.0968-10, tokë bujqësore e klasës së III-të, në Zonën Kadastrale Kaçanik i vjetër në pronësi të Xheladin Krasniqi/ Lënda: 01Nr. 06-350/01-18273/18;
52. Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës Bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr.0968-9, tokë Bujqësore-kullosë e klasës së III-të zona kadastrale Kaçanik i vjetër në pronësi të Xhevahir Krasniqi/ Lënda: 01Nr. 06-350/02-17664/18;
53. Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të parcelës kadastrale nr.0968-7, tokë bujqësore kullosë e klasës së III-të, zona kadastrale Kaçanik i vjetër në pronësi të Abedin Krasniqi/ Lënda: 01Nr. 06-350/01-18276/18;
54. Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2019 dhe vlerësimet për vitet, 2020-2021 / Lënda: 01Nr. 400/01-28721/18;
55. Vendimi për transferimin/ rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit 2018/ Lënda: 01Nr. 400/01-31236/18;
56. Vendimi Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatshkurtër/ Lënda : 01Nr. 104/02-30935/18;
57. Vendimi për ndryshimin e destinimit sipas PZHK për parcelën kadastrale Nr. 516-1, Zona Kadastrale, Kaçanik / Lënda: 01Nr. 104/02-31499/18;
58. Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 350/02- 21705/18 – për rishqyrtimin e Planit zhvillimor komunal për Komunën e Kaçanikut/ Lënda : 01Nr. 104/02- 31498/18.
59. Vendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore të komunës për vitin 2018/ Lënda: 01Nr. 400/01-34711/18:
60. Vendimi për formimin e Komitetit Konsultativ të Personave me aftësi të kufizuara në komunën e Kaçanikut / Lënda : 01Nr. 104/02-34370/18;
61. Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, Agjencisë të punësimit të Republikës së Kosovës / Lënda : 01Nr. 104/02- 31498/18.
62. Vendimi për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal/ Lënda: 01Nr.104/02-34740/18:
63. Vendimi për aprovimin e Planit lokal të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Kaçanikut/ Lënda : 01Nr. 104/02-34843/18;

64. Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar, familjeve në nevojë / Lënda: 01Nr. 08-322/01-39890/18;
65. Vendimi për Aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2019/ Lënda : 01Nr. 60/01-40044/1818;
66. Vendimin për aprovimin e Planit vjetor të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2019/ Lënda: 01Nr. 60/01-40271/18;
67. Vendimin për Aprovimin e Planit të Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2019 / Lënda: 01Nr. 60/01-40049;
68. Vendimin për Aprovimin e Planit të Veprimit për Transparencë për vitin 2019 /Lënda: 01Nr, 60/01-39886/18;
69. Vendimi për Aprovimin e Planit të Integritetit për vitet, 2019-2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-40007/18.

---

**69 Vendime**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

| I Data 21·01·20 | Vendi KAÇANIK |
| --- | --- |
| Nj. org. | Numri | Shtojcë |
| 01 | 60/01-2122 | -/- |

KAÇANIKU

**Republika e Kosovës**

Republika Kosova

Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut

Opština Kacanik

Municipal Kacanik

# INFORMATË

## PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2019

Kaçanik, Janar 2020

PËRMBAJTJA

HYRJE

QËLLIMI

PËRBËRJA E KUVENDIT

KOMPETENCAT E KUVENDIT TË KOMUNËS

MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS

KOMITETET E KUVENDIT

NJOFTIMET PËR MBLEDHJE

AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS

RAPORTIMI I KRYETARIT NË KUVENDIN E KOMUNËS

MONITORIMI I MBLEDHJEVE

PUBLIKIMI I AKTEVE NË WEB FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS

SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE

AKTIVITETE TË TJERA

SHËRBIMI I KUVENDIT

PËRFUNDIM

## Hyrje

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Komuna përmes organeve të saj është e obliguar të ushtroj kompetencat në mënyrë ligjore dhe transparente, duke siguruar edhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

Organet e Komunës janë të obliguara që ushtrimin e veprimtarisë së tyre të zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore të organeve qendrore dhe akteve të cilat i nxjerrin vet. Në kuadër të organeve të komunës, Kuvendi është organi më i lart legjislativ, i cili ushtron funksionin e tij në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Kuvendi mban mbledhjet e rregullta në mënyrë që të kryej funksionet në kuadër të fushë veprimtarisë së tij, të cilat kërkohen me legjislacionin në fuqi.

### Qëllimi

Kjo informatë ka për qëllim informimin e qytetarëve, Organizatave Joqeveritare dhe çdo grupi tjetër të interesit rreth funksionimit të Kuvendit të Komunës të legjislaturës 6, respektivisht aktivitetin 1 vjeçar i Kuvendit të Komunës për vitin 2019, periudha 1 Janar 2019- -31 Dhjetor 2019. Informata shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e Kuvendit të Komunës.

### Përbërja e Kuvendit

Përbërja e Kuvendit të Komunës i dalë nga zgjedhjet e lokale të Republikës së Kosovës të mbajtura më 22 tetor 2017, është 27 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 6 subjekte politike me numër të mandateve : Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 11 mandate, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me 5 mandate, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 4 mandate, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK) me 4 mandate, Nisma për Kosovën(NISMA) me 2 mandate dhe IQ Lista për Kaçanikun me 1 mandat.

Tre anëtarë nga AAK, Shemsedin Luzha, Albana Troni- Lika dhe Hajredin Luta edhe në vitin 2019 vazhdojnë të veprojnë si Grup i Pavarur në Kuvendin të Komunës, dhe vazhdojnë koalicionin me PDK. Anëtari Shemsedin Luzha në ndërkohë hiqet nga grupi i pavarur duke vepruar në KK si i Pavarur, ndërkaq anëtarja e AAK, Afërdita Shehi, nga subjektit politik të AAK që me herët ishte në koalicion me PDK, edhe në vitin 2019 vazhdon funksionin e saj në Kuvendin e Komunës, në opozitë.

### Kompetencat e Kuvendit të Komunës

Kompetencat e Kuvendit të Komunës janë të përcaktuara në nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL). Sipas nenit 40.1 Kuvendi i komunës funksionon në bazë të këtij ligji, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore. Sipas nenit 40.2 Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për: a) statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre, b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese; c) miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo

rregullores së punës; d) planin vjetor të punës dhe raportin vjetor; e) themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij Ligji; f) zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komunës; g) niveli i tarifave dhe ngarkesave; h) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi; i) emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike; j) arritjen e marrëveshjeve ndër komunale dhe brenda komunale; k) marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe l) përgjegjësive të tjera që kërkohen me ligj.

### Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

Ligji për Vetëqeverisje Lokale përcakton rregullat e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të siguroj njëtrajtshmëri të punës së këtij organi. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtë mujorit të parë të vitit.

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut bazuar në nenin 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për gjatë vitit 2019, ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit kanë qenë të hapura për publikun.

Pjesëmarrja e anëtarëve të KK ka qenë kryesisht e rregullt, ka pasur ndonjë mungesë me arsye të ndonjë anëtari, me përjashtim të anëtari i KK nga LVV, Shpend Krusha, i cili ka munguar në tre seanca rresht ( seancat e fundit) pa ndërprerë, kështu që mbetet të shikohet marrja e veprimeve të nevojshme sipas LVL dhe Udhëzimeve Administrativ në fuqi që e rregullojnë këtë fushë, për zëvendësimin e tij.

### Komitetet e Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka të formuar dy Komitete të përhershme;

1. Komiteti për Politikë dhe Financa dhe
2. Komiteti për Komunitete.

Kuvendi ka formuar një Komitet tjetër, që është, Komiteti për Shërbime Publike.

Kuvendi i Komunës ka të formuar një (1) Komitet Konsultativ: Komitetin Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara. Anëtarësimi i anëtarëve të këtij komiteti është bërë në vitin 2019.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka pasur rol të veçantë në trajtimin dhe adresimin e çështjeve të cilat kanë qenë në interesim të përgjithshëm të qytetarëve të komunës. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje, duke shqyrtuar të gjitha pikat që i ka pasur në rend dite dhe i ka përcjell për diskutim dhe miratim në Kuvendin e Komunës. Trajtim të veçantë KPF-ja i ka kushtuar çështjeve financiare siç janë : shqyrtimit të buxhetit, kornizës afatmesme buxhetore të komunës si dhe çështje të tjera siç janë; rregulloret komunale, raporteve financiare, ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë të ndërtimore të PK të klasës së 5 dhe 6 të pronave private në sipas Propozim Vendimeve të DUKMM, duke bazë të kompetencës së bartura nga Kuvendi i Komunës., për të cilat ka marrë vendime 13 adekuate.

Komiteti për Komunitete ka mbajtur 4 mbledhje që kanë qenë të parapara të mbahen në këtë vit. Në mbledhjet e Komitetit për Komunitete janë shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me problemet e qytetarëve. Nga 4 mbledhje sa i ka pasur ky komitet të planifikuara, në vitin 2020 janë planifikuar 10 mbledhje.

Komiteti për Shërbime Publike ka mbajtur gjithsej 5 mbledhje, nga 6 sa i ka të planifikuara për 1 vit. Një mbledhje e këtij komiteti nuk është mbajtur edhe pse është ftuar, për shkak të mungesës së kuorumit. Në mbledhjet e këtij komiteti janë shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë kryesisht me shërbimet publike në Komunën e Kaçanikut.

Sa i përket Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të kufizuara, ky Komitet aktivitetin e tij e ka filluar nga muaji shtator 2019, ndërkaq ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje, ndërkaq për një vit i ka të planifikuara 6 mbledhje. Në mbledhjet e këtij komiteti janë shqyrtuar çështjet që lidhen kryesisht me nevojat e PAK, duke iu referuar Planit të veprimit për PAK në Kaçanik.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, pos tjerash ka formuar edhe Komisione siç janë Komisionin për shqyrtimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, formimin e Komisioneve ad hoc, si Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Komisioni për hartimin e Planit të punës së KK për vitin 2020, ndërkaq iu ka vazhduar mandatin Komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale. Kur jemi te komisionet e kuvendit, sfidë mbetet mungesa e bazës ligjore për kompensimin e tyre.

## Njoftimet për mbledhje

Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës janë njoftuar paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, 7 (shtatë) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftim është shënuar: data e mbajtjes së mbledhjes, koha e mbajtjes së mbledhjes, vendi i mbajtjes së mbledhjes, rendi i ditës për mbledhje edhe materialet e mbledhjes. Materiali i mbledhjes është dërguar në formë elektronike, pasi anëtarët e KK janë pajisur me Laptop.
Gjatë njoftimit dhe ndarjes së materialeve të mbledhjes, i njëjti njoftim është publikuar në ueb faqen e Komunës dhe në Tabelë të shpalljeve.
Njoftimi dhe materialet gjithashtu i janë dërguar edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Materiali i mbledhjes i është dërguar edhe ekzekutivit të komunës, Zyrës së Informimit dhe OJQ.

## Aktet e Kuvendit të Komunës

Në periudhën Janar – Dhjetor 2019, Kuvendi ka shqyrtuar 105 pika të rendit të ditës. Në kuadër të rregullat-ivës normative, KK ka aprovuar 4 Rregullore komunale : Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave; Rregullorja për mbrojtjen e drejtave të fëmijëve; Rregullorja për Transparencë Komunale, ndërkaq në lexim të parë është aprovuar Draft Rregullorja për Ndryshim Plotësimin e Rregullores 01/2018 (01Nr. 02-/01-11899) për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane të Komunës së Kaçanikut. Nga aktet tjera, KK ka aprovuar: Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe Vendimin për miratimin e Buxhetit për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitet 2021-2022, 4 Raporte periodike buxhetore, Plani vjetor i Kuvendit për vitin 2020, Raporti i Kryetarit për aktivitetin e përgjithshëm të Komunës, Raportet dhe Planet e Komiteteve të KK,

Raporti dhe Plani i KKSB. Gjatë kësaj periudhe Kuvendi miratoi 72 Vendime. Aktet e miratuara ndikojnë në krijimin e kushteve sa më të mira të qytetarëve të komunës dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Në këtë drejtim, ka marrë vendime për: dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale, këmbimin e pronave, ndërrimin e destinimit të pronave bujqësore. Vlen me u përmend dy iniciativa të aprovuara: 1. Iniciativa për çështjen e ndërtimit të një kyçje-ç kyçje në Autostradën" Arben Xhaferi". Kërkesa për këtë çështje iu ka adresuar organeve relevante të nivelit qendror për një takim më strukturat e komunës. 2. Iniciativa e Kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndër komunal për realizimin e një projekti, ndërtimin, zgjerimin e rrugës: Gorancë-Kotlinë. KK ka aprovuar vendime të karakterit financiar (rialokim, harmonizim, bartje, transfere) të mjeteve buxhetore sipas Propozim Vendimeve të Kryetarit të Komunës, për një shpenzim më të mirë të buxhetor dhe me qëllim që mjetet buxhetore mos të ngelin në suficit buxhetor. Kur jemi të vendimet me karakter financiar, KK ka marrë vendim për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për çdo person që vdes, ndërkaq në shenjë përkrahje Republikës së Shqipërisë për tërmetin e ndodhur me 26 Nëntor, KK ka ndarë mjete buxhetore në emër të ndihmës për zonat e prekura nga tërmeti.

**Raportimi i Kryetarit në Kuvendin e Komunës**

Në mesin e përgjegjësive të Kryetarit të Komunës është edhe raporti i Kryetari para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare, si administrues i financave të komunës lidhur me shpenzimet komunale, investimet kapitale dhe shfrytëzimin e parasë publike. Kryetari i Komunës e ka përmbushur obligimin për raportim në Kuvendin e Komunës brenda këtij viti, ku forma e raportimit ka qenë me shkrim dhe atë katër herë për gjatë vitit dhe në formë verbale çdo herë kur është kërkuar. Gjithashtu ekzekutivi i komunës i është përgjigjur Kërkesave të anëtarëve të KK aty për aty apo në formë të shkruar. Kjo është një formë më e mirë e bashkëpunimit dhe llogaridhënies së ekzekutivit ndaj Kuvendit të Komunës.

**Monitorimi i mbledhjeve**

Monitorimi i mbledhjeve të Kuvendit edhe gjatë këtij viti ka qenë i vazhdueshëm. Aktiviteti i Kuvendit është monitoruar nga strukturat ndërkombëtare, siç është OSBE-ja e cila kryesisht i ka përcjellë mbledhjet e KK . Ndërkaq nga strukturat vendore, monitorimi është bërë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e cila vazhdimisht përcjell punën dhe aktivitetin e Kuvendit nga distanca përmes teleprezencës. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit janë mbajtur me dyer të hapura, mirëpo interesimi i OJQ-ve dhe grupeve tjera të interesit ka qenë minimal.

**Publikimi i akteve në Ueb faqen zyrtare të Komunës**

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019, të gjitha aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës dhe shkresat tjera të lëndës, dërgohen të skanuara nga Shërbimi i Kuvendit, Zyrës së Informimit dhe Zyrës së IT për t'i publikuar në Ueb faqen zyrtare të Komunës, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit. Vlen të përmendet së, i gjithë aktiviteti i Kuvendit të Komunës i vitit 2019 është i publikuar në faqen e komunës. Kjo mënyrë e publikimit, mundëson qasjen e qytetarëve në të gjitha aktet e Kuvendit të Komunës dhe qasje më të lehtë në dokumente zyrtare. Për t'iu qasur aktiviteteve të Komunës Kaçanik duhet klikuar adresën: https://kk.rks-gov.net/kacanik/

Për t'u qasur aktiviteteve të Kuvendit të Komunës, duhet klikuar në linkun: Kuvendi, pastaj hapen Linqet: Rregulloret, Vendimet, Procesverbalet, Buxheti, Video-incizime, Dokumente dhe aktivitete tjera të Kuvendit sipas viteve.

## Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është autoritet mbikëqyrës i komunave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të miratuara në Kuvend. Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2019, të gjitha aktet e miratuara në Kuvend janë dërguar për shqyrtimin e ligjshmërisë në MAPL. Nga të gjitha aktet e dërguara në MAPL për 2 vendime është kërkuar rishqyrtim i tyre, ndërkaq 2 vendime për dhënien në shfrytëzim afatgjatë(40 vjet) të pronave komunale janë harmonizuar sipas kërkesës së MAPL. 2vendime për çështje të subvencioneve dhe transfereve na është sugjeruar për ekzekutimin e tyre konform procedurave dhe të njëjtat iu është kthyer përgjigje MAPL për procedurat e zhvilluara me shpallje publike. Nga Vendimet e kërkuara për rishqyrtim, është rishqyrtuar, Vendimi për çështjen e ndërtimit të shkollës në f. Doganaj, ndërkaq 2 vendime tjera janë ndryshuar dhe plotësuar për shkak të gabimeve teknike. Me kërkesën e MAPL, është harmonizuar, Rregullorja për Transparencë komunale. Ka pasur edhe vendime të KK për të cilat nuk kemi pasur ndonjë konfirmim të ligjshmërisë nga autoriteti mbikëqyrës ose ligjshmëria është shqyrtuar pas afatit të përcaktuar ligjor, kështu që të njëjtat janë publikuar në faqen zyrtare të komunës në pajtim me afatin e përcaktuar ligjor për publikim e tyre.

## Aktivitete tjera

Krahas punës në Kuvendit, ka pasur edhe aktivitete të tjera edhe jashtë Kuvendit. Kryesuesi ka prezantuara në të gjitha takimet e organizuara nga MAPL, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendit dhe takime tjera me qëllim të shqyrtimit të problematikave ,evidentimin e pengesave që hasen gjatë punës së Kuvendit dhe gjetjen e formave për tejkalimin dhe lehtësimin punës së Kuvendit në zhvillimin e politikave lokale. Krahas angazhimit të kryesuesit edhe anëtarët tjerë të Kuvendit kanë dhënë kontributin e tyre në takimet e ndryshme, trajnime dhe seminare të organizuara nga Ministritë, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Organizatat siç janë OSBE-ja , DEMOS dhe OJQ të tjera. Nga aktivitete tjera është ai i Kryesuesit të KK dhe shefat e grupeve parlamentare të KK, në bashkëpunim me OJQ "Gjethi", "Shoqata Bjeshkatare Alpiniste" Kaçaniku 2015" dhe Administratorët e fshatrave. Tema ka qenë: Gjendja alarmante e shkatërrimit të pyjeve në Parkun Nacional "Sharri". Në këtë takim përpos përfaqësuesve të strukturave ekzekutive të komunës, kanë qenë të ftuar edhe përfaqësues nga: Parku Nacional "Sharri", Policia e Kosovës, Agjencioni Pyjor i Kosovës, Gjykata, Prokuroria, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural. Aktivitet tjetër është, Takimi i mbajtur me, Qendrën Kërkimore për Politika të Sigurisë. Në këtë takim është diskutuar tema: Me demokraci pjesëmarrëse për një Kosovë pa radikalizëm.
Vlen të përmendet së Kuvendi i Komunës ka zhvilluar një vizitë zyrtare në shtetin e Shqipërisë, me qellim të përfitimit të përvojave të KK, ku janë vizituar Bashkia e Beratit, sipas ftesës së Kryetarit të Bashkisë Ervin Demo, ndërkaq është vizituar edhe Bashkia e Elbasanit.

**Shërbimi i Kuvendit**

Punët dhe detyrat e punës së Kuvendit të Komunës dhe trupave punuese të kuvendit, përgatiten nga një (1) zyrtar i punësuar në Shërbimin për punë profesionale të Kuvendit dhe nga një(1) zyrtar i punësuar në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit. Me angazhimin e këtyre zyrtareve, përgatiten; mbledhjet, përpilohen Procesverbalet e mbledhjeve, Vendimet dhe shkresat tjera dhe të njëjtat arkivohet për nevojat e komunës dhe të qytetarëve të saj.

**Përfundim**

- Ftesa për mbledhjet e Kuvendit dhe materialet e mbledhjes janë dërguar, duke respektuar afatet që janë përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale;

- Kuvendi i Komunës, gjatë vitit 2019 ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje të rregullta, apo maksimumi i mbledhjeve që janë të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale;

- Të gjitha mbledhjet e Kuvendit kanë qenë të hapura për qytetarët, OJQ-t dhe grupet tjera të interesit;

- Monitorimi i mbledhjeve, nga strukturat ndërkombëtare është bërë nga OSBE-ja me praninë e tyre fizike , ndërsa nga niveli qendror ,nga MAPL-ja përmes teleprezencës;

- Kuvendi i Komunës ka mbajtur takime publike me qytetarët për buxhetin e komunës;

- Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës është mbajtur procesverbal dhe i njëjti është publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës;

- Kryetari i Komunës ka raportuar 4 herë me raport të shkruar financiar, para Kuvendit të Komunës;

-Aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës, ndërkaq Rregulloret janë publikuar edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

-Të gjitha aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës janë dërguar në MAPL për shqyrtimin e ligjshmërisë, në afatin e përcaktuar ligjor, të përkthyera në dy gjuhë;

-Pjesëmarrja e Kryetarit dhe ekzekutivit në mbledhjet e Kuvendit ka qenë pothuajse i përhershëm;

- Incizimi i mbledhjeve është bërë përmes teleprezencës dhe i njëjti është publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Mërseli

## Lista e Akteve të aprovua në Legjislaturës së gjashtë (6) të Kuvendit të Komunës 2017-2021

### Viti 2019

**Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës në vitin 2019**

**Rregullore**

1. Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Kaçanikut/ Lënda: 01Nr.07- 60/01-17890/19 ;
2. Rregullorja për Mbrojtjen e Drejtave të Fëmijëve / Lënda; 01Nr. 02-60/01-31844/19;
3. Rregullorja për Transparencë Komunale / Lënda: 01Nr. 02-60/01-31847/19.
   -Rregullorja për Transparencë Komunale 03/2019 (01Nr.02-60/01-31847/19) të datës 17 Tetor 2019 me dispozitat ligjore në fuqi, sipas Kërkesës së MAPL të datës 04.11.2019 (harmonizuar sipas Kërkesës së MAPL pas shqyrtimit të ligjshmërisë) / Lënda: 01Nr. 02-60/01-31847/19;
4. Rregullorja për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020 / Lënda: 01Nr. 05-430/03-36755/19;
5. Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores 01/2018 (01Nr. 02-104/01-11899) për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane të Komunës së Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 02-60/01-36408/19.

**Vendime**

1. Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00144-51 ZK, Kaçanik / Lënda: 01Nr. 06-350/02-1721/19;
2. Vendimi për financimin e shpenzimeve të varrimit për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e Komunës së Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 104/02-1514/19;
3. Vendimi për ndryshim plotësimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës / Lënda : 01Nr. 104/02-2312/19;
4. Vendimi për aprovimin e Planit të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2019/ Lënda : 01Nr. 104/02-1839/19;
5. Vendimi për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2018, në vitin 2019 / Lënda : 01Nr. 05-400/01-4632/19;
6. Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, parcelës kadastrale Nr. 00078-2 ZK Kaçanik, me kulturë, Livadh i klasës së 4 (Katërt) në pronësi të Milaim Dogani/ Lënda: 01Nr. 06-351/02-36277/19;
7. Vendimi për lejimin e mjeteve buxhetore nga subvencionet, për realizimin e projekteve të DAK për vitin 2019/Lënda: 01Nr. 400/01-5157/19;
8. Vendimin për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK, për ndarjen e masës drusore të konfiskuara familjeve skamnore/ Lënda: 01Nr. 322/01-5692/19;
9. Vendimin për Lejimin e mjeteve buxhetore për xhirimin e filmit " Ne kërkim të Venerës" / Lënda: 01Nr. 060/03-4584/19;
10. Vendimi për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2018 / Lënda: 01Nr. 060/01-4631/19;
11. Vendimi për Aprovimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019 / Lënda: 01 Nr. 60/01-5181/19;

12. Vendimi për Aprovimin e Planit Komunal i Veprimit për Efiçiencën e Energjisë (PKVEE) për 2019-2021 / Lënda: 01Nr. 07-104/02-8154/19;
13. Vendimi për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës, parcelat kadastrale; 00174-0 dhe 00175-0, Zona Kadastrale Doganaj, për ndërtimin e shkollës së Re "Ali Asllani" në f. Doganaj / Lënda: 01Nr. 104/02-8061/19;
14. Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të parcelave kadastrale Nr. 00229-2 dhe 00229-4, ZK Doganaj, në pronësi të Naser Guri / Lënda: 01Nr. 06-350/01-3151/19;
15. Vendimi për formimin e komisionit të Ankesave për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 60/01-8052/19;
16. Vendimi për Aprovimin Raporti i Punës i Komitetit për Komunitete, për vitin 2018 / Lënda: 01Nr. 060/01-8564/19;
17. Vendimi për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Shërbime Publike, për vitin 2018 / Lënda: 01Nr. 060/01-8600/19;
18. Vendimi për ndryshim plotësimin e Vendimit të KK 01 Nr. 05-400/01-4632/19 të datës 27.02.2019- Për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti fiskal 2018, në buxhetin e komunës të vitit 2019 /Lënda: 01Nr. 400/01-9498/19;
19. Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2019 në kategorinë ekonomike, Paga dhe Mëditje/ Lënda: 01Nr,400/01-11745/19;
20. Vendimi për Shpalljen e interesit të përgjithshëm publik, patundshmëria në f. Bob, për ndërtimin-rregullimin e objekteve publike komunale të sportit Lënda: 01Nr. 104/02-11852/19;
21. Vendimi Paraprak, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00561-3, Zona Kadastrale Kaçanik, me kulturë, Livadh i klasës 1 (Parë), në emër të Ekrem Krraba nga f. Soponicë / Lënda: 01Nr.06-350/02-8720/19;
22. Vendimi Paraprak, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00047-0, Zona Kadastrale Kovaçec, me kulturë, Arë e klasës 3 (Tretë), në emër të Xhemil Burrniku dhe Faruk Burrniku nga f. Kovaçec / Lënda: 01Nr. 06-350/02-8280/19;
23. Vendimi Paraprak, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00751-0, Zona Kadastrale Nikaj, me kulturë, Arë e klasës 4 (Katërt), në emër të Gani Guri nga f. Nikaj / Lënda: 01Nr. 06-350-9574/19;
24. Vendimi Paraprak, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 02166-21, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, me kulturë, Arë e klasës 4 (Katërt), në emër të Muhamet Baftiri nga f. Dubravë / Lënda: 01Nr. 06-350/01-11774/19;
25. Vendimi për Rishpallje të Konkursit për përzgjedhjen e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara / Lënda: 01Nr. 60/01-12570/19;
26. Vendimi për miratimin e nismës së Kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndër komunal, Komunës së Kaçanikut me Komunën e Hanit të Elezit, në fushën e infrastrukturës rrugore në viset rurale/ Lënda: 01Nr. 104/02-12845/19;
27. Vendimi për miratimin e Planit të Reagimit Emergjent për Komunën e Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 104/02-14934/19;
28. Vendimi për Aprovimin e Rekomandimeve të Komisionit për përzgjedhjen e ofertave ekonomikisht me të favorshme për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës / Lënda: 01Nr. 060/01-14677/19;

29. Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas Ligjit të ri në fuqi, Nr. 06/L-092 / Lënda: 01Nr. 104/02-14800/19;
30. Vendimi për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 16-9103/14 të datës 31.03.2014/ Lënda: 01 Nr. 104/02-13617/19;
31. Vendim për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-8061/19 të datës 29.03.2019- Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të ri shkollor në f. Doganaj / Lënda: 01Nr. 60/01-15085/19;
32. Vendimi për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 400/01-11745/19 i datës 30.04.2019- për transferin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019 në kategorinë ekonomike, Paga dhe mëditje/ Lënda: 01Nr. 60/03-15077/19;
33. Vendimi për aprovimin e Kornizës afatmeme buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut për vitet, 2020-2022/ Lënda: Nr. 05-400/01-18025/19;
34. Vendimi për dhënien në shfytëzim afatgjatë të Parcelës Kadastrale Nr. 00217-1, ZK Gërlicë e Epërme, kompanisë N. T " X –PLAST, në emër të Nexhat Vogliqi; Lënda: 01Nr. 104/02-0013023/19;
35. Vendimi për dhënien në shfytëzim afatgjatë të Parcelës Kadastrale Nr. 00124-1 Zona Kadastrale Doganaj dhe Parcelën Kadastrale Nr.00217-3 Zona Kadastral Gërlicë e Epërme, kompanisë NTP ' Muja" me pronarin Muhamet Zenuni/ Lënda: 01Nr.104/02-0013410/19;
36. Vendimi për qëndrimin e masës drusore dhe automjeteve të konfiskuara në Autoparkun e SHIL/ Lënda: 01Nr. 08-320/01-18621/19;
37. Vendimi për formimin e Komisionit të Ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim së pronës së paluajtshme të komunës. / Lënda: 01Nr. 104/02-18863/19;
38. Vendimi për aprovimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të dhënë në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare të Auditimit për PFV 2018 / Lënda: 01Nr. 470/03-21361/19;
39. Vendimi për rialokimin dhe transferin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019 / Lënda: 01Nr. 400/01-22496/19;
40. Vendimi për përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 60/01-18735/19;
41. Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr.104/02-18863/19- të datës 28.06.2019 –Për formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës / Lënda: 01Nr. 104/02-23792/19;
42. Vendimi për miratimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2020 dhe vlerësimet për vitet 2021-2022 / Lënda: 01Nr. 400/01-30433/19;
43. Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019 / Lënda: 01Nr. 400/01-30460/19 ;
44. Vendimi për ndarjen e mjeteve buxhetore për financim të projektit " Instalimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm në lagjen e Epërme të f. Shtrazë/ Lënda: 01Nr. 400/01-30599/19;
45. Vendimin për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019 / Lënda; 01Nr.400/01-34078/19;
46. Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020 / Lënda: 01Nr. 60/02-34108/19;
47. Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të P.K. Nr. 00378-1, në sip.134m2 Z.K Kaçanik, në emër të; Sylejman, Llukman, Azem (Selman) Bela me nga 1/3 e

sipërfaqes, për zgjerimin -ndërtimin e rrugës "Maliq Zharku" në Kaçanik / Lënda: 01Nr. 941/01-34156/19;

48. Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të P.K.Nr. 00947-1, në sipërfaqe, 178m2 Z.K Nikaj, në emër të Shaip (Rushit) Krasniqi nga Kaçaniku, për ndërtimin e një pjese të rrugës "Hamzë Jashari"/ Lënda: 01Nr. 941/01-34158/19;
49. Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës të P.K. Nr. 00968-2 në sip.989m2, Z.K. Nikaj, me pronën e paluajtshme private të P.K. Nr. 00091-1 në sip.781m2, kullosë e klasës së 3 dhe P.K. Nr. 00092-2 me sip.208m2, oborr, ZK Nikaj në emër të Razim(Bedri) Palloshi / Lënda: 01Nr. 941/01-34155/19;
50. Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99 vite) Mevlud Zharkut. pronën e paluajtshme të Komunës, P.K. Nr.01407-0, në Zonë Kadastrale Kaçanik i Vjetër, në sip.2.5930 ha, në vendin "Çardak"- PSHKK- Kaçanik/ Lënda: 01Nr. 104/02-15826/19;
51. Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99 vite) të pronës së paluajtshme të Komunës, N.T.SH " Lypeteni, në emër të Fadil S. Guri, P.K. Nr.01405-0-0, Zona Kadastrale, në sip.0.86.24 ha, Kaçanik i Vjetër në vendin "Çardak"/ Lënda: 01Nr. 104/02-16111/19;
52. Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99 vite) të pronës së paluajtshme të Komunës Fatmir Gashit, P.K Nr.02706-6, në sip.0.20.01 ha, Zona Kadastrale Begracë, P.SH.KK. Kaçanik, / Lënda: 01Nr. 104/02-15795/19;
53. Vendimi për Aprovimin e Planit Komunal për integrimin e qëndrueshëm të peronave të riatdhesuar 2019-2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-36491/19;
54. Vendimi për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut nga Komisioni për Emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale / Lënda: 01Nr. 104/02-36179/19;
55. Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës / Lënda: 01Nr. 60/01-36810/19;
56. Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të Parcelës kadastrale Nr. 00144-36 Zona Kadastrale Kaçanik, me kulturë pyjore Mal i klasës 1, në emër të Selajdin Tusha nga Kaçaniku / Lënda: 01Nr. 06-350/01-33963/19;
57. Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik PK Nr. 01151-5 në ZK Soponicë,në emër të Enver Dalloshi, për këmbim me pronën komunale Nr. 01152-0 në ZK Soponicë / Lënda: 01Nr. 464/01-36826/19;
58. Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik PK numrat: 01211-3 dhe 01211-6 ZK Soponicë, në emër të Muharrem Dalloshi, për këmbim me pronën komunale Nr. 01205-0 ZK Soponicë, / Lënda: 01Nr. 464/01-36827/19;
59. Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik PK Nr. 00881-2, ZK në Kaçanik në emër të Milaim Fuga për këmbim me pronën komunale Nr. 01855-1, ZK Kaçanik, / Lënda: 01Nr. 464/01-36830/19;
60. Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të PK Nr. 01356-2 ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Kullosë e klasës së 3, në emër të Milaim Elezi/ Lënda: 01Nr. 06-351/02-33644/19;
61. Vendimi për harmonizimin e mjeteve buxhetore brenda kategorisë së Pagave dhe Mëditjeve për vitin fiskal 2019/ Lënda: 01Nr. 400/01-37089/19;
62. Vendimi për lejimin e mjeteve buxhetore në emër të ndihmës për zonat e dëmtuara nga tërmeti, Republikës së Shqipërisë/ Lënda: 01Nr. 400/01-38417/19;
63. Vendimi për Aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020/ Lënda: 01Nr. 60/01-39401/19;

64. Vendimi për Aprovimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2020 / Lënda: 060/01-39074/19;
65. Vendimi për Aprovimin e Planit Vjetor i Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Kaçanikut për vitin 2020/ Lënda: 01Nr.60/01-39691/19;
66. Vendimi për Aprovimin e Plani i Veprimit për Transparencë 2020-2023/ Lënda: 01Nr.104/02-39584/19;
67. Vendimi për Ndryshimin e Statusit aktual të KRU "Bifurkacioni" nga Ndërmarrja publike lokale në Ndërmarrje publike qendrore/ Lënda: 01Nr.07-104/02-39515/19;
68. Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar, shkollave të komunës / Lënda: 01Nr. 08-322/01-39425/19;
69. Vendimi për përmirësimin e gabimit teknik të Vendimit të KK 01Nr. 941/01-34155/2019 të datës 31.10.2019 për këmbimin e pronës komunale me pronën private në emër të Razim Palloshi nga f. Biçec / Lënda: 01Nr. 941/01-39854/19.

---

**69 Vendime**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
KAÇANIKU

| I Data 20.01.2020 | | Vendi KAÇANIK |
|---|---|---|
| Nj. org. | Numri | Shtojcë |
| 01 | 60/01-1994 | -/- |


KAÇANIKU

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova**

**Republic of Kosovo**

**Komuna e Kaçanikut**

**Opština Kacanik**

**Municipal Kacanik**

# INFORMATË

## PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2020

**Kaçanik, Janar 2021**

# PËRMBAJTJA

HYRJE

QËLLIMI

PËRBËRJA E KUVENDIT

KOMPETENCAT E KUVENDIT TË KOMUNËS

MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS

KOMITETET E KUVENDIT

NJOFTIMET PËR MBLEDHJE

AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS

RAPORTIMI I KRYETARIT NË KUVENDIN E KOMUNËS

MONITORIMI I MBLEDHJEVE

PUBLIKIMI I AKTEVE NË WEB FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS

SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE

AKTIVITETE TË TJERA

SHËRBIMI I KUVENDIT

PËRFUNDIM

SHTOJCA:
LISTA E AKTEVE TË APROVUARA NGA KUVENDI I KOMUNËS NË VITIN 2020

I. RREGULLORET
II. VENDIMET

## Hyrje

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Komuna përmes organeve të saj është e obliguar të ushtroj kompetencat në mënyrë ligjore dhe transparente, duke siguruar edhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

Organet e Komunës janë të obliguara që ushtrimin e veprimtarisë së tyre të zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore të organeve qendrore dhe akteve të cilat i nxjerrin vet. Në kuadër të organeve të komunës, Kuvendi është organi më i lart legjislativ, i cili ushtron funksionin e tij në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Kuvendi mban mbledhjet e rregullta në mënyrë që të kryej funksionet në kuadër të fushë veprimtarisë së tij, të cilat kërkohen me legjislacionin në fuqi.

### Qëllimi

Kjo informatë ka për qëllim informimin e qytetarëve, Organizatave Joqeveritare dhe çdo grupi tjetër të interesit rreth funksionimit të Kuvendit të Komunës të legjislaturës 6, respektivisht aktivitetin 1 vjeçar i Kuvendit të Komunës për vitin 2020, periudha 1 Janar 2020- -31 Dhjetor 2020. Informata shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e Kuvendit të Komunës.

### Përbërja e Kuvendit

Përbërja e Kuvendit të Komunës i dalë nga zgjedhjet e lokale të Republikës së Kosovës të mbajtura më 22 tetor 2017, është 27 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 6 subjekte politike me numër të mandateve: Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 11 mandate, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me 5 mandate, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 4 mandate, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK) me 4 mandate, Nisma për Kosovën(NISMA) me 2 mandate dhe IQ Lista për Kaçanikun me 1 mandat. Në mbledhjen e parë të vitit 2020, të mbajtur më datë 31.01.2020 anëtari i KK nga LVV, Shpend Krusha pas dorëheqjes, është zëvendësuar nga anëtari tjetër i LVV Agim Mani. Anëtarët Shemsedin Luzha dhe Albana Troni- Lika në mbledhjen e nëntë të Kuvendit të komunës, të mbajtur më datë 30.10.2020 ,deklarohen se kalojnë në subjektin politik LVV. Hajredin Luta edhe në vitin 2020 vazhdon të veprojë si i Pavarur në Kuvendin e Komunës, dhe vazhdon koalicionin me PDK. Ndërkaq anëtarja Afërdita Shehi- Horuni, nga subjektit politik i AAK jep dorëheqje si anëtare e Kuvendit komunal, edhe në vend të saj,në mbledhjen e shtatë të mbajtur me datë 08.09.2020, zëvendësohet nga anëtarja tjetër e AAK, Rabije Sallahi.

### Kompetencat e Kuvendit të Komunës

Kompetencat e Kuvendit të Komunës janë të përcaktuara në nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL). Sipas nenit 40.1 Kuvendi i komunës funksionon në bazë të këtij ligji, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore. Sipas nenit 40.2 Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për: a) statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre, b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese; c) miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës; d) planin vjetor të punës dhe raportin vjetor; e) themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij Ligji; f) zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të

komunës; g) niveli i tarifave dhe ngarkesave; h) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi; i) emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike; j) arritjen e marrëveshjeve ndër komunale dhe brenda komunale; k) marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe l) përgjegjësive të tjera që kërkohen me ligj.

**Mbledhjet e Kuvendit të Komunës**

Ligji për Vetëqeverisje Lokale përcakton rregullat e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të siguroj njëtrajtshmëri të punës së këtij organi. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtë mujorin e parë të vitit. Për shkak të gjendjes me Pandeminë Covid-19, në muajt Mars dhe Prill nuk janë mbajtur mbledhje të rregullta të KK sipas planit të punës. Në muajin Mars është mbajtur mbledhje e jashtëzakonshme, në të cilën është marrë Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës emergjente të krijuar nga pandemia Covid-19/Lënda 01Nr.400/01-8928/20.

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut bazuar në nenin 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për gjatë vitit 2020, ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe një mbledhje të jashtëzakonshme. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit janë mbajtur në sallën e kuvendit dhe kanë qenë të hapura për publikun. Për shkak të pandemisë Covid -19, jemi munduar me i krijuar të nevojshme anëtarëve të KK me mbajtjen e distancës fizike të ulëseve në sallë, maska mbrojtëse dhe dezinfektues.
Pjesëmarrja e anëtarëve të KK ka qenë kryesisht e rregullt, ka pasur ndonjë mungesë me arsye të ndonjë anëtari, për shkak të pandemisë, me përjashtim të anëtares së KK nga AAK, Afërdita Horuni (Shehi)e cila ka munguar në tri seanca rresht pa arsye. Pas këtyre seancave, Afërdita Horuni (Shehi) ka ofruar dorëheqjen dhe pas të gjitha procedurave është zëvendësuar me anëtaren tjetër nga radhët e AAK, Rabije Sallahi.

**Komitetet e Kuvendit të Komunës**

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka të formuar dy Komitete të përhershme;

1. Komiteti për Politikë dhe Financa dhe
2. Komiteti për Komunitete.

Kuvendi ka formuar një Komitet tjetër, që është, Komiteti për Shërbime Publike.
Kuvendi i Komunës ka të formuar një (1) Komitet Konsultativ: Komitetin Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara. Anëtarësimi i anëtarëve të këtij komiteti është bërë në vitin 2019.
Komiteti për Politikë dhe Financa ka pasur rol të veçantë në trajtimin dhe adresimin e çështjeve të cilat kanë qenë në interes të përgjithshëm të qytetarëve të komunës. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje, duke shqyrtuar të gjitha pikat që i ka pasur në rend dite dhe i ka përcjell për diskutim dhe miratim në Kuvendin e Komunës. Trajtim të veçantë KPF-ja i ka kushtuar çështjeve financiare siç janë : shqyrtimit të buxhetit, kornizës afatmesme buxhetore të komunës, çështjet financiare dhe çështje të tjera me rëndësi për komunën, siç janë; rregulloret komunale, raporteve financiare, ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë të ndërtimore të PK të klasës së 5 dhe 6 të pronave private sipas Propozim Vendimeve të DUKMM, në bazë të kompetencës së bartura nga Kuvendi i Komunës, për të cilat ka marrë vendime adekuate.

Komiteti për Komunitete ka mbajtur 10 mbledhje që kanë qenë të parapara me planin e punës të mbahen në këtë vit. Në mbledhjet e Komitetit për Komunitete janë shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me problemet e qytetarëve.

Komiteti për Shërbime Publike ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje aq sa i ka pasur të planifikuara për1 vit sipas planit të punës. Në mbledhjet e këtij komiteti janë shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë kryesisht me shërbimet publike në Komunën e Kaçanikut.

Sa i përket Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të kufizuara, ky Komitet aktivitetin e tij e ka filluar nga muaji shtator 2019, ndërkaq gjatë vitit 2020 ka mbajtur gjithsej 5 mbledhje nga të 6 sa kanë qenë të planifikuara. Në mbledhjet e këtij komiteti janë shqyrtuar çështjet që lidhen kryesisht me nevojat e PAK, duke iu referuar Planit të veprimit për PAK në Kaçanik. .

Kuvendi i Komunës Kaçanik, pos tjerash ka formuar edhe Komisione siç janë Komisionin për shqyrtimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, formimin e Komisioneve ad hoc, si Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Komisioni për hartimin e Planit të punës së KK për vitin 2021, ndërkaq iu ka vazhduar mandatin Komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale. Kur jemi të komisionet e kuvendit, sfidë mbetet mungesa e bazës ligjore për kompensimin e tyre.

**Njoftimet për mbledhje**

Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës janë njoftuar paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, 7 (shtatë) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftim është shënuar: data e mbajtjes së mbledhjes, koha e mbajtjes së mbledhjes, vendi i mbajtjes së mbledhjes, rendi i ditës për mbledhje edhe materialet e mbledhjes. Materiali i mbledhjes është dërguar në formë elektronike, pasi anëtarët e KK janë pajisur me Laptop.
Gjatë njoftimit dhe ndarjes së materialeve të mbledhjes, i njëjti njoftim është publikuar në ueb faqen e Komunës dhe në Tabelë të shpalljeve.
Njoftimi dhe materialet gjithashtu i janë dërguar edhe Ministrisë së Pushtetit Lokal (MPL), në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Materiali i mbledhjes i është dërguar edhe Kryetarit të Komunës, drejtorëve të drejtorive komunale , Zyrës së Informimit dhe OJQ.

**Aktet e Kuvendit të Komunës**

Në periudhën Janar – Dhjetor 2020, Kuvendi i Komunës ka shqyrtuar 81 pika të rendit të ditës. Në kuadër të rregullat-ivës normative, KK ka bërë ndryshim plotësimin e Statuti të Komunës së Kaçanikut 01Nr.3588/2008 të datës 25.09.2008, ka aprovuar 4 Rregullore komunale: Rregullorja Nr.01/2020 për Ndryshim Plotësimin e Rregullores 01/2018 (01Nr. 02-104/01-11899) për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane të Komunës së Kaçanikut, Rregullorja Nr. 02/2020 për Taksat komunale, Rregullorja Nr. 03./2020 -për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me pak së një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregullorja Nr. 04/2020 për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës. Rregullorja për taksat komunale ka qenë dy herë në rend pune, pasi që e njëjta në një mbledhje është harmonizuar në pajtim më kërkesën e MPL.

Nga aktet tjera, KK ka aprovuar; Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe Vendimin për miratimin e Buxhetit për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022-2023, Tri (tre) Raporte periodike buxhetore, Plani vjetor i Kuvendit për vitin 2021, Raporti i Kryetarit për aktivitetin e përgjithshëm të Komunës për vitin 2019, Raportet dhe Planet e Komiteteve të KK, Raporte dhe Plani i KKSB, Raporte për përfundimin e vitit shkollor 2020, raport për fillimin e vitit shkollor 2020/2021. Gjatë kësaj periudhe për shkak të gjendjes me Pandeminë Covid-19, është formuar edhe Shtabi komunal për parandalimin e Pandemisë Covid-19, me ç 'rast në Kuvend është raportuar 3 herë me Raport të punës së Shtabit komunal për parandalimin e Pandemisë Covid-19. Gjatë vitit 2020 Kuvendi i Komunës ka miratuar 43 Vendime. Aktet e miratuara ndikojnë në krijimin e kushteve sa më të mira të qytetarëve të komunës dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Në këtë drejtim, ka marrë vendime për: dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale, këmbimin e pronave, ndërrimin e destinimit të pronave bujqësore, vendim që drutë e konfiskuara t'ua ndajë shkollave të komunës. Vlen me u përmend dy iniciativa të aprovuara: 1. Deklaratë për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së, 2. Iniciativa e Kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Shtërpcës. KK ka aprovuar vendime të karakterit financiar (rialokim, harmonizim, bartje, transfere) të mjeteve buxhetore sipas Propozim Vendimeve të Kryetarit të Komunës, për një shpenzim më të mirë buxhetor dhe me qëllim që mjetet buxhetore mos të ngelin në suficit buxhetor. Kur jemi të vendimet me karakter financiar, KK ka marrë Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës emergjente të krijuar nga pandemia Covid-19, Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit të KK-së 01Nr.104/02-1514/19 të datës 29.01.2019- për financimin e shpenzimit të varrimit të rasteve mortore në Komunën e Kaçanikut. Në vitin 2020 janë bërë ndryshim plotësime në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Komitetin për Shërbime Publike. Aktiviteti i Kuvendit të Komunës Kaçanik mund të vlerësohet së ka qenë shumë i mirë, nuk ka pasur lëshim apo bojkotim të asnjë mbledhje, çështjet kryesisht janë aprovuar me shumicë votash, disa nga çështjet janë miratuar njëzëri, ndërkaq nuk e ka marrë miratimin një rekomandim i komisionit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale për katër dhjetë(40) vjet.

**Raportimi i Kryetarit në Kuvendin e Komunës**

Në mesin e përgjegjësive të Kryetarit të Komunës është edhe raporti i Kryetari para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare, si administrues i financave të komunës lidhur me shpenzimet komunale, investimet kapitale dhe shfrytëzimin e parasë publike. Kryetari i Komunës e ka përmbushur obligimin për raportim në Kuvendin e Komunës brenda këtij viti, ku forma e raportimit ka qenë me shkrim dhe atë tre (3) herë për gjatë vitit dhe në formë verbale çdo herë kur është kërkuar. Gjatë kësaj periudhe për shkak të gjendjes me Pandeminë Covid-19, Kryetari ka formuar edhe Shtabin komunal për parandalimin e Pandemisë Covid-19, me ç 'rast në Kuvend është raportuar tre (3) herë me Raporte të punës së Shtabit komunal për parandalimin e Pandemisë Covid-19 .Gjithashtu ekzekutivi i komunës i është përgjigjur Kërkesave të anëtarëve të KK aty për aty në raste të caktuara, apo kryesisht në formë të shkruar. Kjo është një formë më e mirë e bashkëpunimit dhe llogaridhënies së ekzekutivit ndaj Kuvendit të Komunës.

**Monitorimi i mbledhjeve**

Aktivitetit i Kuvendit monitorohet nga strukturat ndërkombëtare - OSBE-ja e cila i përcjellë mbledhjet e KK dhe KPF përmes: Faruk Dermaku dhe Gazmend Murseli. Nga strukturat vendore,

monitorimi është bërë nga Ministria e Administrimit e Pushtetit Lokal e cila vazhdimisht përcjell punën dhe aktivitetin e Kuvendit nga distanca përmes teleprezencës nga zyrtari, Gëzim Sahiti. Nga OJQ, Instituti Demokratik (KDI), përmes, Kjani Sallahu, janë përcjellë të gjitha mbledhjet e KK. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit janë mbajtur me dyer të hapura, mirëpo përpos KDI, interesimi i OJQ të tjera, qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit, ka qenë minimal.

**Publikimi i akteve në Ueb faqen zyrtare të Komunës**

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, të gjitha aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës dhe shkresat tjera të lëndës, dërgohen të skanuara nga Shërbimi i Kuvendit, Zyrës së Informimit përkatësisht Zyrës së IT për t'i publikuar në Ueb faqen zyrtare të Komunës, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit, mbledhjeve të KPF-së ,të Komitetit për Komunitete si dhe procesverbalet e dëgjimeve publike të organizuara nga Kryesuesi i Kuvendit përmes KPF-së lidhur me buxhetin e Komunës. Vlen të përmendet së, i gjithë aktiviteti i Kuvendit të Komunës i vitit 2020 është i publikuar në faqen zyrtare të komunës. Kjo mënyrë e publikimit, mundëson qasjen e qytetarëve në të gjitha aktet e Kuvendit të Komunës dhe qasje më të lehtë në dokumente zyrtare. Për t'iu qasur aktiviteteve të Komunës Kaçanik duhet klikuar adresën: https://kk.rks-gov.net/kacanik/, Duke klikuar linkun: Kuvendi, hapen Linqet: Rregulloret, Vendimet, Procesverbalet, Buxheti, Video-incizime, Dokumente dhe aktivitete tjera të Kuvendit të Komunës sipas viteve.

**Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve**

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është autoritet mbikëqyrës i komunave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të miratuara në Kuvend. Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2020, të gjitha aktet e miratuara për të cilat kërkohet shqyrtim i ligjshmërisë, janë dërguar Zyrës Ligjore të MPL. Nga të gjitha aktet e dërguara në MAPL për 2 vendime është kërkuar rishqyrtim i tyre ( 1. Vendimi 01Nr. 060/01-13851/20 i datës 12.08.2020 për Kompensimin e komisioneve të KK 2. Vendimi Paraprak 01Nr. 06-350/01-9350/20 i datës 27.05.2020 - për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Azem Guri. Këto dy vendime janë anuluar nga Kuvendi i Komunës në pajtim më kërkesën e organit shqyrtues -MPL. Nga aktet tjera të rishqyrtuara është, Rregullorja 01Nr. 02-60/01-4863/20 -për Taksat Komunale, e cila është harmonizuar sipas Kërkesës së MPL. Ka pasur edhe vendime të KK për të cilat nuk kemi pasur ndonjë konfirmim të ligjshmërisë nga autoriteti mbikëqyrës, kështu që të njëjtat janë publikuar në faqen zyrtare të komunës, në pajtim me afatin e përcaktuar ligjor për publikim e tyre.

**Aktivitete tjera**

Me qëllim të shqyrtimit të problematikave, evidentimin e pengesave që hasen gjatë punës së Kuvendit dhe gjetjen e formave për tejkalimin dhe lehtësimin punës së Kuvendit në zhvillimin e politikave lokale, krahas punës së Kuvendit, ka pasur edhe aktivitete të tjera edhe jashtë Kuvendit, si të Kryesuesit të Kuvendit dhe anëtarëve tjerë të KK. Takimet e tilla janë mbajtur më tepër në formë online-për shkak të pandemisë Covid-19, organizuar nga MPL, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendit, OSBE, DEMOS dhe OJQ të tjera, Në pamundësi të ndërtimit të sallës së re të KK, me qëllim të krijimit të kushteve sadopak më të mira të sallës së mbledhjeve të KK, me mjetet e planifikuara të vizitës zyrtare të KK jashtë vendit, e cila vizitë nuk është realizuar për shkak të pandemisë -Covid -19.,është intervenuar në renovimin e sallës së KK.

**Shërbimi i Kuvendit**

Punët dhe detyrat e punës së Kuvendit të Komunës dhe trupave punuese të kuvendit, përgatiten nga një (1) zyrtar i punësuar në Shërbimin për punë profesionale të Kuvendit dhe nga një(1) zyrtar i punësuar në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit. Me angazhimin e këtyre zyrtareve, përgatiten; mbledhjet, përpilohen Procesverbalet e mbledhjeve, Vendimet dhe shkresat tjera dhe të njëjtat arkivohet për nevojat e komunës dhe të qytetarëve të saj. Të gjitha aktet e aprovuara nga KK, përmes këtyre zyrtarëve, pas nënshkrimit nga Kryesuesi i KK, në formë origjinale i dërgohen: Kryetarit të Komunës dhe drejtorive përkatës me qëllim të ekzekutimit të tyre, ndërkaq Zyrës Ligjore të MPL, i dërgohen në formë elektronike përmes zyrtarit të KK, për shqyrtimin e ligjshmërisë së tyre, në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimeve Administrative që e rregullojnë këtë çështje.

**Përfundim**

Nga të shënuarat si më lartë, nxjerrim një përfundim lidhur me aktivitetin e Kuvendit të Komunës në vitin 2020, si vijon:

- Ftesa për mbledhjet e Kuvendit dhe materialet e mbledhjes janë dërguar, duke respektuar afatet që janë përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale;
- Kuvendi i Komunës, gjatë vitit 2020 ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje të rregullta dhe 1 mbledhje të jashtëzakonshme, apo maksimumin e mbledhjeve me pagesë, që janë të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale
- Të gjitha mbledhjet e Kuvendit kanë qenë të hapura për qytetarët, OJQ-t dhe grupet tjera të interesit;
- Monitorimi i mbledhjeve, nga strukturat ndërkombëtare është bërë nga OSBE-ja, Nga niveli qendror –MPL, mbledhjet janë monitoruar përmes teleprezencës, ndërkaq nga OJQ janë monitoruar nga Instituti Demokratik (KDI);
- Janë mbajtur 2 takime publike me qytetarët nga Kryesuesi i Kuvendit në konsultim me KPF, për Buxhetin e komunës 2021- 2023 1. Njëri takim është mbajtur me administratorë të fshatrave, lagjeve dhe vendbanimeve urbane, 2. Takimi tjetër është mbajtur me OJQ dhe Grupe tjera të interesit.
- Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës është mbajtur procesverbal dhe i njëjti është publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës;
- Kryetari i Komunës ka raportuar 3 herë me raport të shkruar financiar, para Kuvendit të Komunës; 3 herë për Raport të shtabit komunal për parandalimin e Covid-19 dhe 2 herë me raport në emër të KKSB për çështje të sigurisë;
-Aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës, ndërkaq Rregulloret janë publikuar edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
-Të gjitha aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës, ashtu siç i parasheh UA janë dërguar në MPL për shqyrtimin e ligjshmërisë, në afatin e përcaktuar ligjor, të përkthyera në dy gjuhë;
-Pjesëmarrja e Kryetarit në mbledhje të Kuvendit ka qenë e përhershme në mbledhje të KK, ndërkaq kryesisht kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive;
- Incizimi i mbledhjeve është bërë përmes teleprezencës nga zyrtari i IT dhe i njëjti është publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Mërseli

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVO

## Lista e Akteve të aprovua në Legjislaturës së gjashtë (6) të Kuvendit të Komunës 2017-2021

# Viti 2020

**Lista e Akteve të Aprovuara nga KK në vitin 2020:**

**Rregullore**

1. Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 01/2018 (01Nr. 02-104/01-11899) për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane të Komunës së Kaçanikut / Lënda: 01 Nr. 60/01-36408/19;
2. Statuti për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut, 01Nr.3588/2008 të datës 25.09.2008/ Lënda: 01Nr. 60/01-12895/20;
3. Rregullorja për Taksat Komunale/ Lënda: 01Nr. 60/01-4863/20;

- Rregullore për taksat komunale, e harmonizuar në bazë të komenteve të MPB / Lënda: 01Nr. 02-60/01-4863/20;

4. Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me pak së një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës/ Lënda: 01Nr. 02- 104/02-26493/20;
5. Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës/ Lënda: 01Nr. 04-610/01-30862/20.

**5 Akte normative**

**Vendime:**

1. Vendimi për Emërtimin dhe Riemërtimin e rrugëve lokale/ Lënda: 01Nr. 104/02-1699/20;
2. Vendimi për Aprovimin e Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020 / Lënda: 060/01-1918/20;
3. Vendimi për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Kaçanikut për periudhën: Janar-Shtator 2019/ Lënda: 01Nr.60/01-2076/20;
4. Vendimi për Aprovimin e Plani të Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2020 / Lënda: 01Nr.60/01-2249/20;
5. Vendimi për miratimin e Nismës së Kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndër komunal; me Komunën e Shtërpcës/ Lënda: 01Nr.104/02-2476/20;
6. Vendimi për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2019 / Lënda: 060/01-5004/20;
7. Vendimi për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019 Lënda: 01Nr.60/01-5452/20;
8. Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 60/01-368/19 – për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës / Lënda: 01Nr.104/02-3037/20;
9. Vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës emergjente të krijuar nga pandemia COVID -19 / Lënda: 01Nr. 400/01-8928/20;
10. Vendimi paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Azem Guri nga f. Nikaj/ Lënda: 01Nr. 06-350/01-9350/20;

11. Vendimi për lirim nga qiraja komunale shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2020 si dhe lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore deri në përfundim të pandemisë Covid - 19 / Lënda: 01Nr. 60/01-9754/20;
12. Vendimi për Rialokim të mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020/ Lënda: 01Nr.400/01-9755/20;
13. Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pa shpenzuara në buxhetin e komunës për vitin 2020 / Lënda ; 01Nr. 400/01-9757/20;
14. Vendimi për Aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut për vitet 2021-2023 / Lënda: 01Nr. 400/01-12855/20;
15. Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për N.K.P "Stacioni i Autobusëve" SH.A. – Kaçanik / Lënda: 01Nr. 60/01-12899/20;
16. Vendimi për rialokim dhe transfer të mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020 / Lënda: 01Nr. 400/01-12923/20;
17. Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën private të Mustafë Lama, për ndërtimin e rrugës në Kaçanik të Vjetër/ Lënda: 01Nr. 350/01-11436/20;
18. Vendim për Raportit të punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2019/ Lënda: 01Nr. 60/01-15000/20;
19. Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr. 104/02-1514/19 të datës 29.01.2019 për financimin e shpenzimeve të varrimit për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e Komunës së Kaçanikut/ Lënda: 01Nr.07-104/02-15302/20;
20. Vendimi për formimin e komisionit për identifikimin e parcelave në pronësi të Komunës së Kaçanikut, në të cilat ndodhën puset, rezervuarët e ujit, stacionet e pompimit, ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore të cilat janë asete të KRU" Bifurkacioni" SHA Ferizaj / Lënda: 01Nr.07-104/02-15307/20;
21. Vendimi për anulimin e Vendimit Paraprak 01Nr. 06-350/01-9350/20 të datës 27.05.2020- për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore/ Lënda: 01Nr. 350/02-16206/20;
22. Deklaratë për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës/ Lënda: 01Nr. 60/01-15987/20;
23. Vendimin për kompensimin e komisioneve të Kuvendit të Komunës / Lënda: 01Nr. 060/01-18351/20;
24. Vendimin për rialokimin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2020/ Lënda: 01Nr. 400/01-20296/20;
25. Vendimin për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020/ Lënda: 01Nr. 104/02-21420/20;
26. Vendimin për aprovimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve në raportin e auditimit për PVF 2019;
27. Vendimin për ndryshim plotësimin e Vendimit 01Nr. 104/02-18863/19 të datës 28.06.2020 për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim / Lënda: 01Nr. 104/02-20723/20;
28. Vendimin për miratimin e Buxhetit të Komunës për vitin fiskal 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022-2023 / Lënda: 01Nr. 060/01-22954/20;
29. Vendimin për rialokim dhe transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2020/ Lënda: 01Nr. 400/01-23019/20;
30. Vendimin për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik ZK në Strazhë, për projektin" Ndërtimi i Zonës Turistike –"Malet e Sharrit"/ Lënda: 01Nr. 060/01-22944/20;

31. Vendim për Anulimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-22499/20 i datës 12.08.2020 - Për kompensimin e Komisioneve të Kuvendit të Komunës Kaçanik / Lënda: 01Nr. 060/01-27581/20;
32. Vendimin për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK 01 Nr. 60/01-504/18 të datës 28.02.2018 për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" SH.A. - Njësia në Kaçanik / Lënda: 01Nr. 060/01-26898/20;
33. Vendimi për formimin e komisionit për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-26879/20;
34. Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2020/ Lënda: 01 Nr. 400/01-26309/20;
35. Vendimin për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01Nr. 60/01-1785/2018 – përkatësisht Vendimit për ndryshim plotësimin e Vendimit 01Nr. 60/01-5524/2018 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa / Lënda: 01Nr. 060/01-27538/20;
36. Vendimin për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021 / Lënda: 01Nr. 104/02-29060/20;
37. Vendimin për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK 01Nr. 104/01-1879/18 të datës 28.02.2018 për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) / Lënda: 01Nr. 104/02-29023/20;
38. Vendimin për aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021/ Lënda: 01Nr. 060/01-28891/20;
39. Vendimin për transfer të mjeteve nga kategoria e pagave dhe shtesave sipas buxhetit të vitit 2020 / Lënda: 01Nr. 104/02-28960/20;
40. Vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm publik, patundshmëria e Parcelës Kadastrale Nr. 00494-15 në ZK Kaçanik për zgjerimin dhe ndërtimin e rrugës " Ismail Raka" në Kaçanik, / Lënda: 01Nr. 07-464/01-30640/20;
41. Vendimin për ndarjen e masës drusore të konfiskuara gjatë vitit 2020, shkollave të komunës së Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 104/02-31030/20;
42. Vendimin për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK 01Nr. 104/02-12812/2018 të datës 27.04.2020 – Për formimin e Komitetit për Shërbime Publike / Lënda: 01Nr. 104.02-29811/20 ;
43. Vendimin për aprovimin e Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2021/ Lënda: 01Nr. 060/01-29866/20.

---

**43 Vendime**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

KAÇANIKU

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal Kacanik**

**01Nr.** 60/01-36188 **/21**
**Kaçanik, 23.11.2021**

# INFORMATË

## PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2021

## (LEGJISLATURA E GJASHTË E KK, 2017-2021)

**Kaçanik, 2021**

PËRMBAJTJA


HYRJE______

QËLLIMI ______

PËRBËRJA E KUVENDIT ______

KOMPETENCAT E KUVENDIT TË KOMUNËS ______

MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS______

KOMITETET E KUVENDIT______

NJOFTIMET PËR MBLEDHJE______

AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS______

RAPORTIMI I KRYETARIT NË KUVENDIN E KOMUNËS______

MONITORIMI I MBLEDHJEVE______

PUBLIKIMI I AKTEVE NË WEB FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS______

SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE______

AKTIVITETE TË TJERA______

SHËRBIMI I KUVENDIT______

PËRFUNDIM______

## Hyrje

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Komuna përmes organeve të saj është e obliguar të ushtroj kompetencat në mënyrë ligjore dhe transparente, duke siguruar edhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

Organet e Komunës janë të obliguara që ushtrimin e veprimtarisë së tyre të zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore të organeve qendrore dhe akteve të cilat i nxjerrin vet. Në kuadër të organeve të komunës, Kuvendi është organi më i lart legjislativ, i cili ushtron funksionin e tij në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Kuvendi mban mbledhjet e rregullta në mënyrë që të kryej funksionet në kuadër të fushë veprimtarisë së tij, të cilat kërkohen me legjislacionin në fuqi.

### Qëllimi

Kjo informatë ka për qëllim informimin e qytetarëve, Organizatave Joqeveritare dhe çdo grupi tjetër të interesit rreth funksionimit të Kuvendit të Komunës të legjislaturës gjashtë (6), respektivisht aktivitetin e Kuvendit të Komunës, periudha 1 Janar 2021 deri me inaugurimin e Kuvendit të Komunës të legjislaturës së 7 të KK. Informata shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e Kuvendit të Komunës.

### Përbërja e Kuvendit

Përbërja e Kuvendit të Komunës i dalë nga zgjedhjet e lokale të Republikës së Kosovës të mbajtura më 22 tetor 2017, është 27 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 6 subjekte politike me numër të mandateve : Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 11 mandate, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me 5 mandate, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 4 mandate, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK) me 4 mandate, Nisma për Kosovën(NISMA) me 2 mandate dhe IQ Lista për Kaçanikun me 1 mandat.

Në mbledhjen e 2 (dytë) të Rregullt të KK-së,të datës 26.02.2021, anëtari i Kuvendit të Komunës Besim Vishi deklaron me shkrim se kalon nga subjekti politik PDK në LVV. Ndërsa në mbledhjen e 6 (gjashtë) të Rregullt të KK-së, të datës 15.06.2021, anëtarja e Kuvendit të Komunës, Hafize Sallahi deklarohet se kalon nga subjekti politik Nisma në subjektin politik të AAK.

### Kompetencat e Kuvendit të Komunës

Kompetencat e Kuvendit të Komunës janë të përcaktuara në nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL). Sipas nenit 40.1 Kuvendi i komunës funksionon në bazë të këtij ligji, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore. Sipas nenit 40.2 Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për: a) statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre, b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese; c) miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës; d) planin vjetor të punës dhe raportin vjetor; e) themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij Ligji; f) zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komunës; g) niveli i

tarifave dhe ngarkesave; h) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi; i) emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike; j) arritjen e marrëveshjeve ndër komunale dhe brenda komunale; k) marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe l) përgjegjësive të tjera që kërkohen me ligj.

**Mbledhjet e Kuvendit të Komunës**

Ligji për Vetëqeverisje Lokale përcakton rregullat e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të siguroj njëtrajtshmëri të punës së këtij organi. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtë mujorin e parë të vitit.

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut bazuar në nenin 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale në vitin 2021 ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit kanë qenë të hapura për publikun.

Pjesëmarrja e anëtarëve të KK ka qenë kryesisht e rregullt, ka pasur ndonjë mungesë me arsye të ndonjë anëtari.

**Komitetet e Kuvendit të Komunës**

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka të formuar dy Komitete të përhershme;

1. Komiteti për Politikë dhe Financa; dhe
2. Komiteti për Komunitete.

Kuvendi ka formuar një Komitet tjetër, që është, Komiteti për Shërbime Publike.

Kuvendi i Komunës ka të formuar një (1) Komitet Konsultativ: Komitetin Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara. Anëtarësimi i anëtarëve të këtij komiteti është bërë në vitin 2019.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka pasur rol të veçantë në trajtimin dhe adresimin e çështjeve të cilat kanë qenë në interesim të përgjithshëm të qytetarëve të komunës. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje, duke shqyrtuar të gjitha pikat që i ka pasur në rend dite dhe i ka përcjell për diskutim dhe miratim në Kuvendin e Komunës. Trajtim të veçantë KPF-ja i ka kushtuar çështjeve financiare siç janë : shqyrtimit të buxhetit, kornizës afatmesme buxhetore të komunës si dhe çështje të tjera më rëndësi, siç janë; rregulloret komunale, raporteve financiare, ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë të ndërtimore të PK të klasës së 5 dhe 6 të pronave private sipas Propozim Vendimeve të DUKMM, në bazë të kompetencës së bartura nga Kuvendi i Komunës, për të cilat ka marrë vendime adekuate. Vlen të përmendet zëvendësim i një anëtareje që është bërë në këtë komitet me vendim të KK, për shkak të kalimit të saj në subjekt tjetër politik, mirëpo vendimi është kthyer nga MAPL për shkak së është kërkuar respektimi i Ligjit për barazi gjinore, ndërkaq në atë subjekt politik nuk ka pasur kandidate femër për me bërë zëvendësimin.

Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsej 7(shtatë) mbledhje, nga 10 (dhjetë) që kanë qenë të parapara të mbahen në këtë vit. Në mbledhjet e Komitetit për Komunitete janë shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me problemet e qytetarëve.

Komiteti për Shërbime Publike ka mbajtur gjithsej 2 (dy) mbledhje,nga 6 (gjashtë) që kanë qenë të planifikuara për 1 vit. Në mbledhjet e këtij komiteti janë shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë kryesisht me shërbimet publike në Komunën e Kaçanikut.

Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të kufizuara, ka mbajtur 1 (një) mbledhje, ndërkaq për një vit i ka të planifikuara 6 (gjashtë) mbledhje. Në mbledhjet e këtij komiteti janë shqyrtuar çështjet që lidhen kryesisht me nevojat e Persona me Aftësi të Kufizuara, duke iu referuar Planit të veprimit për PAK në Kaçanik. Nga 7 anëtarë sa ka ky komitet, vlen të përmendet së një anëtare ka dhënë dorëheqje në muajin prill 2021, për shkak të migrimit të saj jashtë vendit, ndërkaq nuk është zëvendësuar me ndonjë anëtar tjetër.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, pos tjerash ka formuar edhe Komisione siç janë: Emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore; Komisioni për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçanik i Vjetër, i cili komision me vonë me vendim të KK është anuluar me kërkesë të autoritetit mbikëqyrës. ndërkaq ia ka pushuar mandatin Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, për shkak së në periudhën e caktuar të zgjedhjeve lokale, sipas vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nuk lejohet të epen prona komunale në shfrytëzim. Kur jemi të komisionet e kuvendit, si çdo vit tjetër edhe në vitin 2021, sfidë mbetet mungesa e bazës ligjore për kompensimin e tyre.

**Njoftimet për mbledhje**

Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës janë njoftuar paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, 7 (shtatë) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftim është shënuar: data e mbajtjes së mbledhjes, koha e mbajtjes së mbledhjes, vendi i mbajtjes së mbledhjes, rendi i ditës për mbledhje, duke ia bashkangjitur materialin e mbledhjes. Materiali i mbledhjes është dërguar në formë elektronike, pasi anëtarët e KK janë të pajisur me Laptop.
Gjatë njoftimit dhe ndarjes së materialeve të mbledhjes, i njëjti njoftim është publikuar në ueb faqen e Komunës dhe në Tabelë të shpalljeve.
Njoftimi dhe materialet gjithashtu i janë dërguar edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Materiali i mbledhjes i është dërguar edhe ekzekutivit të komunës, Zyrës së Informimit dhe OJQ, ndërkaq prej strukturave ndërkombëtare i është dërguar OSBE-së.

**Aktet e Kuvendit të Komunës**

Në periudhën Janar – Shtator 2021, Kuvendi ka shqyrtuar 71 pika të rendit të ditës. Në kuadër të rregullat-ivës normative, ka aprovuar 2 Rregullore komunale: Rregullorja Nr.01/2021 Për organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale dhe Rregullore e brendshme Nr.02/2021 -Për Përdorimin e Automjeteve Zyrtare. Nga çështjet tjera, me rëndësi për komunën, KK ka aprovuar; Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe Vendimin për miratimin e Buxhetit për vitin 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024, dy (2) Raporte periodike

buxhetore, Plani vjetor i Kuvendit për vitin 2021, Raporti i Kryetarit për aktivitetin e përgjithshëm të Komunës, Raportet dhe Planet e Komiteteve të KK, Raportet dhe Plani i KKSB, ka miratuar gjithsej 44 Vendime. Aktet e miratuara ndikojnë në krijimin e kushteve sa më të mira të qytetarëve të komunës dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Në këtë drejtim, ka marrë vendime për: dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale, këmbimin e pronave, ndërrimin e destinimit të pronave bujqësore. Kuvendi i Komunës gjatë periudhës raportuese ka aprovuar vendime të karakterit financiar (rialokim, harmonizim, bartje, transfere) të mjeteve buxhetore sipas Propozim Vendimeve të Kryetarit të Komunës, për një shpenzim më të mirë buxhetor dhe me qëllim që mjetet buxhetore mos të ngelin në suficit buxhetor.

**Raportimi i Kryetarit të Komunës**

Në mesin e përgjegjësive të Kryetarit të Komunës është edhe Raporti i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare, si administrues i financave të komunës lidhur me shpenzimet komunale, investimet kapitale dhe shfrytëzimin e parasë publike. Kryetari i Komunës e ka përmbushur obligimin për raportim në Kuvendin e Komunës brenda këtij viti, ku forma e raportimit ka qenë me shkrim dhe atë 3 herë ka raportuar për gjatë vitit 2021 dhe në formë verbale çdo herë kur është kërkuar për çështjet financiare, 2 herë ka raportuar për gjendjen e Sigurisë me Raport të shkruar të KKSB, 1 herë ka raportuar për Aktivitetin e përgjithshëm të Ekzekutivit të Komunës, përfshirë edhe menaxhimin e burimeve njerëzore, 1 herë është raportuar për çështjen e arsimit dhe 1 herë ka raportuar për zbatimit te rekomandimeve të Auditorit për pasqyrat vjetore 2020; me raport të shkruar -Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit për Pasqyrat vjetore financiare për vitin fiskal 2020. Gjithashtu ekzekutivi i komunës i është përgjigjur kryesisht pyetjeve dhe kërkesave të anëtarëve të KK aty për aty apo në formë të shkruar. Kjo është një formë më e mirë e bashkëpunimit dhe llogaridhënies së Ekzekutivit të Komunës ndaj Kuvendit të Komunës.

**Monitorimi i mbledhjeve**

Nga strukturat vendore, monitorimi i mbledhjeve të Kuvendit është bërë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e cila vazhdimisht përcjell punën dhe aktivitetin e Kuvendit nga distanca përmes teleprezencës. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit janë mbajtur me dyer të hapura, mirëpo interesimi i OJQ-ve dhe grupeve tjera të interesit ka qenë minimal.

**Publikimi i akteve në Ueb faqen zyrtare të Komunës**

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021, të gjitha aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës dhe shkresat tjera të lëndës, dërgohen të skanuara nga Shërbimi i Kuvendit, Zyrës së Informimit dhe Zyrës së IT për t'i publikuar në Ueb faqen zyrtare të Komunës, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit, mbledhjeve të KPF-së dhe të Komitetit për Komunitete. Vlen të përmendet se i gjithë aktiviteti i Kuvendit të Komunës i vitit 2021 është i publikuar në faqen e komunës. Kjo mënyrë e publikimit, mundëson qasjen e qytetarëve në të gjitha aktet e Kuvendit të Komunës dhe qasje më të lehtë në dokumente zyrtare. Për t'iu qasur aktiviteteve të Komunës Kaçanik duhet klikuar adresën: https://kk.rks-gov.net/kacanik/. Për t'u qasur aktiviteteve të Kuvendit të Komunës, duhet klikuar në linkun: Kuvendi, pastaj hapen Linqet: Rregulloret, Vendimet, Procesverbalet, Buxheti, Video-incizime, Dokumente dhe aktivitete tjera të Kuvendit sipas viteve.

## Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është autoritet mbikëqyrës i komunave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të miratuara në Kuvend. Gjatë vitit 2021, të gjitha aktet e miratuara në Kuvend janë dërguar për shqyrtimin e ligjshmërisë në MAPL. Nga të gjitha aktet e dërguara në MAPL për 7 vendime është kërkuar rishqyrtim i tyre, si : Vendimi 01Nr. 60/01-7155/21- për ndryshim plotësimin e vendimit të KK 01nr. 60/01-36810/19 i datës 29.11.2019 dhe vendimit 01nr. 104/02-3037/20 i datës 28.02.2020- për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, Vendimi 01Nr.104/02-11086/21 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, për katër dhjetë (40) vjet, pronën e paluajtshme të komunës, personit juridik: JLG Construction SH.P.K.-Kaçanik, NUI:811498642, me pronar Agron Zeneli-Kaçanik, me procedurë të negocimit të ofertës, Vendimi 01nr.60/01-15789/21 - për themelimin e komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçanik i Vjetër.
Vendimi 01Nr.60/01-18413/21- për ndryshim plotësimin e vendimit KPF formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa. Vendimi 01 Nr. 06-350/02-8304/21 -për shpallje me interes të përgjithshëm publik , patundshmërinë në pjesën e PK 01003-0 ZK Kaçanik, pronë private në emër të Misim Sopa, për këmbim me pronën komunale me pjesën e PK 01030-0 ZK Kaçanik. Të gjitha këto vendime janë rishqyrtuar dhe vendosur sipas kërkesave të autoritetit mbikëqyrës.
Vlen të përmendet edhe Vendimi 01Nr 104/02-21139/21-për ndryshim plotësimin e Vendimit për Emërtimin dhe Riemërtimin e Rrugëve Lokale pas Shqyrtimit të Ankesave, Kërkesave dhe Propozimeve nga Qytetarët e Komunës së Kaçanikut (Harmonizuar sipas Kërkesës së MAPL përkatësisht MMPH), miratuar me 30.07.2021, i cili vendim është rishqyrtuar në 2 mbledhje dhe është anuluar.

## Aktivitete tjera

Krahas punës së Kuvendit, ka pasur edhe aktivitete të tjera edhe jashtë Kuvendit. Kryesuesi ka prezantuara në të gjitha takimet e organizuara nga MAPL, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendit dhe takime tjera me qëllim të shqyrtimit të problematikave ,evidentimin e pengesave që hasen gjatë punës së Kuvendit dhe gjetjen e formave për tejkalimin dhe lehtësimin punës së Kuvendit në zhvillimin e politikave lokale. Krahas angazhimit të kryesuesit edhe anëtarët tjerë të Kuvendit kanë dhënë kontributin e tyre në takimet e ndryshme, trajnime dhe seminare të organizuara nga Ministritë, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Organizatat siç janë OSBE-ja , DEMOS dhe OJQ të tjera.
Vlen të përmendet së anëtarët e Kuvendit të Komunës kanë zhvilluar një vizitë zyrtare në qytetin e Strugës, sipas ftesës së Kryetarit të Këshillit të Komunës së Strugës, Resul Kaba, me qëllim të përfitimit të përvojave dhe rritjen e bashkëpunimit në mes të dy komunave.

## Shërbimi i Kuvendit

Punët dhe detyrat e punës së Kuvendit të Komunës dhe trupave punuese të kuvendit, përgatiten nga një (1) zyrtar i punësuar në Shërbimin për punë profesionale të Kuvendit dhe nga një(1) zyrtar i punësuar në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit. Me angazhimin e këtyre zyrtareve, përgatiten; mbledhjet, përpilohen Procesverbalet e mbledhjeve, Vendimet dhe shkresat tjera dhe të njëjtat arkivohet për nevojat e komunës dhe të qytetarëve të saj.

**Përfundim**

- Ftesa për mbledhjet e Kuvendit dhe materialet e mbledhjes janë dërguar, duke respektuar afatet që janë përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale;

- Kuvendi i Komunës, gjatë vitit 2021 ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje të rregullta, apo minimumi i mbledhjeve që janë të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale;

- Të gjitha mbledhjet e Kuvendit kanë qenë të hapura për qytetarët, OJQ-t dhe grupet tjera të interesit;

- Monitorimi i mbledhjeve, është bërë nga niveli qendror - MAPL-ja, përmes teleprezencës.

- Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës është mbajtur procesverbal dhe i njëjti është publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës;

- Kryetari i Komunës ka raportuar 3 herë me raport të shkruar financiar, para Kuvendit të Komunës;

-Aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës, ndërkaq Rregulloret janë publikuar edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

-Të gjitha aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës janë dërguar në MAPL për shqyrtimin e ligjshmërisë, në afatin e përcaktuar ligjor, të përkthyera në dy gjuhë;

-Pjesëmarrja e Kryetarit dhe ekzekutivit në mbledhjet e Kuvendit ka qenë pothuajse i përhershëm;

- Incizimi i mbledhjeve është bërë përmes teleprezencës dhe i njëjti është publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Në përmbyllje të këtij raporti, vlen të përmendet së kjo legjislaturë (Legjislatura e 6) e Kuvendit të Komunës përfundon mandatin 4 vjeçar në këtë vit- vitin 2021. Zgjedhjet lokale për legjislaturën e shtatë (7) janë mbajtur me 17 Tetor 2021. Fushata zgjedhore ka filluar me 16 Shtator 2021.

Kryesuesi i Kuvendit (në detyrë)

Kemal Mërseli

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

## Lista e Akteve të aprovua në Legjislaturës së gjashtë (6) të Kuvendit të Komunës 2017-2021

### Viti 2021

**Lista e Akteve të Aprovuara nga KK në vitin 2021:**

**Rregullore:**

1. Rregullore për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale/ Lënda: 01Nr. 104/01-1991/21.
2. Rregullore e brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare/ Lënda: 01Nr. 02-60/01-16867/21.

---

**2 Rregullore**

**Vendime**

1. Kodi i Etikës për zyrtarët e Komunës së Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 02-104/02-1688/21;
2. Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për katër dhjet (40) vjet parcelat me numrat 70917086-00402-0; 70917086-00403 në Zonën Kadastrale Kaçanik i Vjetër, kompanisë "KAÇINKA" L.L.C, NUI : 811389429 / Lënda: 01Nr.104/02-30658/20;
3. Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit të KK 01Nr. 104/02-18863/19 të datës 28.06.2019 dhe Vendimit 01Nr. 104/02-20723 të datës 08.09.2020 për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës/ Lënda: 01Nr. 104/02-1520/21;
4. Vendim për miratimin e Planit të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021 / Lënda: 01Nr. 104/02-2048/21;
5. Vendim për Aprovimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-2016/20;
6. Vendim për Aprovimin e Planit të Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-2259/21;
7. Vendim për Aprovimin e Planit të Punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik, për vitin 2021 / Lënda: 01Nr.60/01-2256/21.
8. Vendimin për lirim nga qiraja komunale për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2021 / Lënda: 01Nr.104/02-5531/21;
9. Vendimi për Aprovimin e Raportit të punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2020 / Lënda 01Nr. 60/01-5260/21;
10. Vendim për miratimin e organogramit të Komunës Kaçanik / Lënda: 01Nr. 104/02-7837/21;
11. Vendimi për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore / Lënda: 01Nr. 104/02-7673/21;
